

Autorë:

Mr. Marijana Lonçar-Velkova
Kryetare e Organizatës të konsumatorëve në Maqedoni

Dr. Jadranka Daboviq-Anastasovska
Profesor i rregullt në Fakultetin Juridik „Justinijani i Parë"
Universiteti „ Shën Kirili dhe Metodij" - Shkup

Elizabeta Spiridonova
Bashkëpunëtoresh dhe këshilltare për edukimin dhe informimin e konsumatorëve në Maqedoni
Organizata e konsumatorëve në Maqedoni

Sofka Koceva
Këshilltare në Byronë e zhvillimit të arsimit

Mr. Aleksandar Nikolov
Ekspert për përgjegjësi shoqërore në sipërmarrësi

Përkthyes:

Lumnje Ajdari

Mivedete Mahmuti

Ky doracak është hartuar nga Organizata e konsumatorëve në Maqedoni dhe Byroja e zhvillimit të arsimit në Republikën e Maqedonisë. Përgatitja dhe botimi janë financuar nga Ambasada e Zvicrës në Maqedoni.

Me doracakun, njëherësh përkrahet edhe programi për arsim për mbrojtjen e konsumatorëve, miratuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit, që njëkohësisht paraqet kontribut në realizimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

PARATHËNIE

Lënda mësimore „Shkathtësitë e jetesës“ – e cila mësohet si lëndë zgjedhore në klasën e VII, VIII dhe IX – fokusohet në më shumë njësi tematike midis të cilave edhe mbrojtja e konsumatorëve.

Doracaku dedikohet për mësimdhënësit të cilët e ligjërojnë lëndën ose do të realizojnë projekte të lira të nxënësve, përkatësisht aktivitete me nxënësit për mbrojtjen e të drejtave të tyre si konsumatorë.

Qëllimi është që përmes Doracakut mësimdhënësve t’iu ofrohen njohuri të reja, informata dhe ide praktike për realizimin e përmbytjeve dhe temave për të drejtat e konsumatorëve dhe politikës në Republikën e Maqedonisë, me të cilat do të mund ta njohin për së afërmi problematikën e e nxënësve. **Në këtë mënyrë nxënësit do ti begatojnë edhe më shumë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre duke praktikuar dhe realizuar të drejtat e tyre si konsumatorë dhe shfrytëzues të shërbimeve, njëherësh do të aftësohen dhe do të mund të sjellin vendime të drejta konsumatore dhe do të mund të përballen me sfidat e jetesës bashkëkohore.**

Doracaku i përfshinë temat në vijim:

- të drejtat e konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë;
- siguria e prodhimeve;
- siguria e ushqimit;
- mbrojtja e të dhënave personale;
- të drejtat digjitale;
- efikasiteti energjetik;
- shkrim - leximi financiar;
- lojërat shpërblyese dhe blerja përmes Internetit.

Temat janë një përqym edhe i sfidave të reja me të cilat ballafaqohen tinxherët. Ky grup i popullsisë gjithnjë e më tepër vuan nga pasojat e të ushqyerit jo të drejtë, nga e gjithë kjo si pasojë e shpeshtë paraqitet mbipesha. Të rinjtë nuk janë të edukuar dhe informuar sa duhet për ushqimin e planifikuar dhe reklamimin e ushqimeve me nivel të lartë në yndyrë, krip dhe sheqer, të cilat edhe më shumë e komplikojnë gjendjen. Gjithashtu, në kohën e Internetit, të rinjtë kanë mundësi që lehtë të kenë qasje në përmbytjet joadekuate. Rrjetet sociale, megjithatë paraqesin kërcënim për reklamat në shënjestër për blerje dhe përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të caktuara. Shitësit me reklamimin e tillë e shfrytëzojnë gjurmën digjitale të cilën personat e mitur e lënë, me qëllim t’iu dërgojnë, pa njohurinë e tyre, reklama të përshtatura për shijet e tyre si konsumatorë, ose akoma më keq, për prodhime të cilat „iu pëlqejnë“ shokëve të tyre. Në këtë mënyrë hfrytëzohet presioni social që grupi e kryen mbi të, ndërsa ata veçanërisht janë të pambrojtur. Gjendja dhe dobësia është më e theksuar te fëmijët dhe konsumatorët e vegjël të cilët njëkohësisht përballen me një faktor shtesë të cenueshmërisë (paaftësisë, rritjes pa kujdes prindëror, rritjes në familje me të ardhura të ulëta dhe kështu me rradhë).

Doracaku do të ndihmojë dhe njëkohësisht do të kontribuojë drejtë përforcimit të edukimit të konsumatorëve të rinj për të rritur besimin e tyre në përditshmërinë e tyre gjatë blerjes dhe shfrytëzimit të prodhimeve dhe shërbimeve. Si persona të rinj të cilët vetëm sa kanë hyrë si konsumatorë në treg, ata duhet të jenë të informuar dhe edukuar për këtë lëmi, ndërsa edukimi pikënisjen e tij duhet ta sigurojë në procesin mësimor. Doracaku ka për qëllim ta ngritë edukimin e konsumatorëve në një nivel më të lartë duke i dhënë edhe vendin e rëndësishëm në procesin arsimor dhe shpresojmë se do të kontribuojë ndaj zhvillimit të ideve të reja, po ashtu edhe ndaj risive si dhe plotësimit të kaheve didaktike me qëllim të ngritjes së vetëdijes të nxënësit për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si konsumatorë.

Mr. Vesna Horvatović

Drejtor në Byronë e zhvillimit të arsimit

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I EDUKIMIT TË KONSUMATORËVE

Informimi dhe edukimi i konsumatorëve është pjesë me rëndësi të posaçme nga edukimi i tyre i përgjithshëm. Parapëlqehet nocioni edukimi i konsumatorëve se sa informimi, sepse informimi për dallim nga edukimi nuk kërkon angazhim apo përkushtim të madh në nivelin intelektual dhe emocional. Edukimi i konsumatorëve zhvillon aftësitë që të bëhet përzgjedhje e mirë konsumit, ndihmon gjatë sjelljes së vendimeve efektive të konsumit, përparësitë parashtrihen me ndërgjegje në kahe drejt përmirësimit të jetës së përditshme në mënyrë qëndrueshëm.

Ky edukim nuk duhet të kahëzohet drejt transmetimit të nocioneve ekonomike, sqarimit si funksionon ekonomia e tregut, formimit të çmimeve etj. Edukimi i konsumit ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, botëkuptimet, shkathtësitë dhe aftësitë të cilat janë të patjetërsueshme për jetesë në një shoqëri konsumatorësh dhe nënkupton pranimin e përgjegjësisë e cila sendërtohet dhe kultivohet përmes sistemit arsimor.

Edukimi mundëson adaptim të drejtë të informatave të konsumit dhe krijon mundësi për të bërë zgjedhje të përgjegjshme të konsumit përmes njohjes së konsumatorëve me obligimet dhe të drejtat e tyre. Në veçanti është e rëndësishme që përmes procesit të edukimit konsumatorët të zhvillojnë aftësitë për të kërkuar këshillë kur iu nevojitet, paraqitje të ankesave dhe zgjidhje efikase të problemeve eventuale. Me edukimin e konsumatorëve, gjithashtu zhvillohen edhe aftësitë për kryerjen e buxhetit familjar si dhe aftësinë për njohurinë e ndikimit social dhe ekonomik nga vendimi i sjellë i konsumit. Kjo është zakonisht e rëndësishme, sepse ajo përkon me qëllimin global në edukimin e konsumatorëve, e ajo është: nga njohuria – deri në veprim.

Edukimi i konsumatorëve ka për qëllim të krijojë një komponent, të sigurt, konsumator aktiv i cili mendon dhe vendos në kontekst më të gjërë. Ajo kontribuon në zhvillimin e kulturës politike, demokratizimit të shoqërisë dhe zhvillimit të shoqërisë qytetare. Nga këto shkaqe ky edukim duhet të kuptohet si një proces afatgjatë dhe i ndërlikuar.

SI TË PËRDORET KY UDHËZUES?

Doracakut jep informata hyrëse dhe përgatitore për mësimdhënësin, shembuj me kahe didaktike për realizimin e tyre si dhe elementet e evaluimit.

Modulet për mbrojtjen e konsumatorëve si pjesë përbërëse e arsimit për shkathtësitë e jetesës, aktivitetet e lira të nxënësve dhe projektet hulumtuese – janë mënyrat për realizimin e temave të kësaj lëmie. Kombinimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, sipas modelit të bazave evropiane elektronike (për sh. <http://www.consumerclassroom.eu/>), çdo herë në pikëqendër janë vënë nxënësit, përderisa mësimdhënësit kanë rolin e moderatorëve dhe udhëzues të kaheve përkatëse. Sidomos duhen të studiohen: nevojat, njohuritë paraprake, përmbajtjet, lëmitë dhe aktivitetet adekuate të mjedisit si dhe përzgjedhja e veglave me të cilat do të motivojnë nxënësit dhe teknikat e punës. Të ofrojnë projekte kërkimore, shembuj në bazë të përvojave dhe ngjashëm.

Gjatë shfrytëzimit të doracakut duhet pasur parasysh se edukimi i konsumatorëve nuk njihet paragjykim dhe reklamë të prodhimeve të caktuara. Për këtë arsye mësimdhënësi iu sugjerohet të marrin qëndrim neutral sa i përket prodhimeve dhe shërbimeve, pa favorizimin e tyre, në qoftë se i japin si shembuj. Gjithashtu, mësimdhënësit nuk duhet të favorizojnë marka të caktuara tregëtare, vetshërbime dhe shitore. Në këtë mënyrë nxënësve nuk iu imponohet mendimi dhe ata do të mund të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur. Në këtë kontekst nuk është e preferuar të përdoren fazat siç janë:

„reklama jonë e njohur“, „e njihni këtë prodhim – për çdo ditë e përdorim“, „ky zbutës i rrobave ka aromë më të mirë“, etj. Është mirë të përdoret terminologjia neutrale – për shembull prodhim i blerë nga ndonjë shitore, pa u theksuar saktë prej nga është blerë prodhimi, cila markë tregtare, ose çfarë reklame posedon.

Në veçanti duhet pasur kujdes në shembujt që prezantohen gjatë realizimit të aktiviteteve të mos nxisin përzgjedhje të padëshiruara të konsumit. Për shembull, mësimdhënësi nuk duhet të theksojë se sa nxënësit i preferojnë çokollatat dhe gjërat tjera, ose ti favorizojë ato prodhime përmes shembujve për deklaratën e prodhimeve dhe reklamave. Kjo është në kundërshtim me kahet e Organizatës Ndërkombëtare të konsumatorëve e cila promovon konsumim sa më të vogël të këtij lloji të prodhimeve, për shkak të ndikimit të tyre në rritjen e mbipeshës te fëmijët.

Gjatë shfrytëzimit të Doracakut preferohet që mësimdhënësit ti lexojnë burimet e orientuara të informatave. Gjithashtu, çdo herë mund të drejtohen edhe te Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë, ekspertë të cilët janë në dispozicion për të siguruar mbështetje dhe ndihmë.

PËRMBAJTJA

1. Të drejtat e konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë

- A) Dokumentet mbështetëse të prodhimit (Ilogaria fiskale, garancia dhe fletë garancia, tregues i prodhimit/deklaratë)
- B) Prodhime me mangësi – të drejtat dhe procedurat gjatë këtyre rasteve
- C) Sjellje jo e mirë tregtare gjatë shitjes të prodhimeve dhe shërbimeve
- Ç) Institucionet kompetente

2. Siguria e prodhimeve

- A) Prodhime të kozmetikës
- B) Lodrat dhe siguria e tyre
- C) Prodhime të falsifikuara
- Ç) Institucionet kompetente

3. Siguria e ushqimit

- A) Etiketimi i drejtë i prodhimeve ushqimore sipas llojeve të prodhimeve
- B) Lëmitë e mbrojtjes dhe institucionet kompetente

4. Mbrojtja e të dhënave personale

5. Të drejtat digjitale

6. Efikasiteti energjetik

7. Shkrim - leximi financiar

8. Lojërat shpërblyese dhe blerje përmes Internetit

- A) Lojëra shpërblyese
- B) Blerje përmes Internetit

1. TË DREJTAT THEMELORE TË KONSUMATORËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Materiali bazë për përgatitjen e mësimdhënësit

Për lëmin tematike „Të drejtat e konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë“, mësimdhënësi duhet të përgatitet përmes njohjes të së drejtave themelore të konsumatorëve të cilat janë caktuar me Ligjin e mbrojtjes së konsumatorëve. Njëherësh, me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së konsumatorëve, kushtet për punë tregtare, të drejtat dhe obligimet e shoqatës së konsumatorëve dhe kompetenca e organeve të drejtorisë shtetërore në raport me mbrojtjen e konsumatorëve.

Mësimdhënësi duhet ta theksojë vetëm atë që i nevojitet nxënësit, në lloj të informatës nga Ligji, ndërsa të mos kërkojë nga nxënësit ta studiojnë Ligjin në fjalë!

Resurset plotësuese

Mësimdhënësi mund t'i studiojë dhe shfrytëzojë edhe broshurat ekzistuese të Organizatës të konsumatorëve në Maqedoni për këtë çështje, me qëllim që materijen më së miri t'ua ofrojë ose përcjellë nxënësve, edhe atë:

- „Sjellje e pandershme tregtare“;
- „Shitja e prodhimeve me çmim të lirë“;
- „Mënyra e realizimit të së drejtave të konsumatorëve të prodhimet me mangësi“;
- „Të drejtat e konsumatorëve të prodhimet me mangësi“, dhe
- „Kush i mbron të drejtat e konsumatorëve?“

Broshurat e përmendura, si dhe informatat plotësuese mund ti hasni në ueb faqen e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë: www.opm.org.mk.

A) DOKUMENTET TË CILAT E SHOQËROJNË PRODHIMIN (LLOGARIA FISKALE, GARANCIA DHE FLETA E GARANCISË, TREGUESIT E PRODHIMIT/DEKLARATA)

LLOGARIA FISKALE

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

Tregtari e ka të domosdoshme që pas çdo prodhimi që e shet, përkatësisht shërbimit të bërë konsumatorit t'i jep llogari fiskale.

Llogaria fiskale është dëshmi se konsumatori rregullisht e ka blerë prodhimin nga tregtari i caktuar. Njëkohësisht, paraqet bazë për realizimin e së drejtës për ta zëvendësuar, kthejë ose të fitojë prodhim të ri në qoftë se prodhimi i blerë nga shkaqe të caktuara nuk i përmbushë nevojat e konsumatorit, nuk përshtatet për qëllimin për të cilin është blerë, përkatësisht për shkak të servisimit të nevojshëm prodhimi është prishur, ose ka treguar jo përputhshmëri në afatin e garantuar.

Në qoftë se prodhimi nuk përshtatet në aspektin e formës, madhësisë, modelit, ngjyrës, numrit ose për shkaqe tjera (përveç në rast të prodhimit të blerë të përgatitur sipas porosisë) konsumatori ka të drejtë të tregtari të cili ka blerë prodhimin mund ta ndërrojë me prodhim të cilësisë përkatëse. Kjo e drejtë mund të realizohet në afat prej 15 ditë nga dita kur është blerë prodhimi, në qoftë se prodhimi nuk është përdorur, nëse është ruajtur pamja, vetitë e përdorimit, blombat, etiketat e fabrikës si dhe **llogaria fiskale**. Nëse në momentin e parashtrimit të kërkesës nga konsumatori, tregtari nuk ka prodhim përkatës që do ti përgjigjet nevojave të tij, konsumatori ka të drejtë sipas përzgjedhjes së tij të kërkojë: refuzimin e kontratës dhe kthimin e shumës së paguar në para ose zëvendësimin e prodhimit me prodhim përkatës nëse ka një produkt të tillë.

Tregtari është i detyruar ta informojë konsumatorin i cili ka kërkuar zëvendësimin e prodhimit se ka prodhim të tillë për shitje në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

● AKTIVITETI: LLOGARIA FISKALE – PSE NA NEVOJITET?

Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të kuptojnë rëndësinë e llogarisë fiskale dhe të dinë ta lexojnë atë;
- ⇒ të dijnë dhe të mundën ta shfrytëzojnë në situatë të krijuar;
- ⇒ të ruajnë dhe ta kuptojnë pse është e nevojshme ta bëjnë atë;
- ⇒ të dijnë se prodhimi mund të reklamohet.

Mjetet mësimore: fatura të mbledhura, llogari fiskale nga nxënësit, hamer, flomasterë.





Vendi i realizimit: klasë, vetëshërbim, shitore, qendra e shërbimeve dhe ngjashëm.

Kohëzgjatja e aktivitetit: një orë mësimore



Rrjedha e aktivitetit:

Për realizimin e kësaj përmbajtje mund të mendohen mënyra më të ndryshme, edhe atë vizitë, ose hulumtime në qendrat tregtare, shitore, sallone për ondulim, shërbime mjekësore etj. Sipas vendbanimit dhe mundësive bëhet skenimi – përgatitja e aktiviteteve, mësimdhënësi udhëzon kahet, detyrat dhe më pas i ndjek nxënësit dhe jep sqarime.

Sot bleva	Më dhanë llogari fiskale	Nuk më dhanë llogari fiskale	E mora, por nuk e ruajta llogarinë fiskale	E ruajta llogarinë fiskale
				
Prodhimi 1			X	
Prodhimi 2	X			
Prodhimi 3 ...				X

Nxënësit ndahen në tre grupe dhe tregojnë se çka kanë blerë javën e kaluar ose sot. Pastaj për secilin grup vizatohet tabelë siç tregohet kjo tabelë më poshtë. Në mbarim sumohen topthat e ngjyrosur sipas grupeve dhe për të gjitha grupet në përgjithësi.

Hapet debati në pajtim me rezultatin e fituara. Për shembull, në qoftë se shumica e nxënësve janë deklaruar se e kanë marrë llogarinë fiskale, por nuk e kanë ruajtur, mësimdhënësi sqaron se pse është e nevojshme llogaritë duhet ruajtur edhe atë për një kohë të gjatë.

Nxënësit motivohen në mënyrë të pavarur të punojnë në hamer në të cilin do të ngjisin llogaritë dhe do të theksojnë çka kanë blerë. Në qoftë se njëri prej tyre ka shembull të caktuar, përkatësisht ka hasur probleme të caktuara që kanë të bëjnë me mos dhënien ose mos ruajtjen e llogarisë fiskale, i thekson të njëjtat. **Përderisa nuk paraqitet nxënës i cili do të tregojë shembull, atëherë mësimdhënësi jep shembull dhe fillon debati.**

Shembulli: Keni blerë dhuratë (këmishë) për shokun tuaj sepse ka ditëlindjen. Si do të veproni kur t'ia jepni atij dhuratën?

- Vallë me dhuratën ia jepni edhe llogarinë fiskale, ose i thoni se të njëjtën e ruan njëri prej jush në qoftë se dëshiron dhuratën ta zëvendësojë për ndonjë arsye tjetër?
- Si vijon procedura nëse shoku dëshiron ta ndërrojë prodhimin (këmishën) sepse është e vogël, ndërsa atij i nevojitet një numër më i madh?

Porosia: Çdo herë merreni dhe ruajeni llogarinë fiskale! Pa llogari fiskale, të drejtat e konsumatorit nuk mund të realizohen.

Mund të bëhet rezyme dhe të kontrollohen rezultatet e pritura.

Pyetje:

P. Vallë shitësi patjetër t'iu jep llogari fiskale?

Përgj. Po, sepse për ndryshe nuk do të mundem ta kthej, zëvendësoj ose të marr prodhim të ri në qoftë se prodhimi i blerë nuk i përmbushë nevojat e mia, ose nuk përshtatet për qëllimin të cilin është blerë.

P. Afati sa gjatë ta ruajë llogarinë fiskale?

Përgj. Më së paku për gjithë atë kohë për të cilën vlen garancia.



GARANCIA për funksionim të drejtë të prodhimit

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

Konsumatorët duhet të informohen mirë për të drejtat të cilat dalin nga garancia për funksionim të drejtë të prodhimeve. Garancia detyrimisht i jepet konsumatorit gjatë blerjes së prodhimeve teknike (teknikë e bardhë, biçikleta, kompjutorë, telefona celularë si dhe shumë prodhime tjera teknike dhe telekomunikative). Tregtari është i detyruar ti japë konsumatorit garanci për cilësi, përkatësisht për funksionim të drejtë të prodhimit. Ai është i detyruar së paku në periudhë prej pesë vjet nga dita e prodhimit ose dy vite pas skadimit të fletës garanci të prodhimit të sigurojë pjesë rezervë. Prodhimi mund të servisohet më së shumti **tre herë** në suaza të afatit garantues. Në qoftë se nuk përmirësohet produkti, konsumatori ka të drejtë të kërkojë nga tregtari ta ndërrojë produktin me një produkt të njëjtë të ri, ose t'i kthehet shuma e pagesës për produktin e blerë. Të gjitha shpenzimet- materiali, pjesët rezerve, puna, transporti – të cilat krijohen gjatë eliminimit të defektit, përkatësisht zëvendësimin e prodhimit/produktit, në bazë të garancës, çdo herë bien mbi barrë të tregtarit e jo mbi barrë të konsumatorit.

Mangësitë që zbulohen nga konsumatori, tregtari doemos duhet ti shmangë në afat prej 30 ditë nga momenti i parashtrimit të kërkesës. Për prodhimet të cilat shërbejnë për përdorim më të gjatë tregtari është i detyrueshëm, pas pranimit të kërkesës nga konsumatori menjëherë ti jep prodhim adekuat të cilin konsumatori do ta shfrytëzojë gjatë kohës së rregullimit të prodhimit.

Në rast të shmangies të mungesës së prodhimit, afati garancë vazhdohet gjatë kohës në të cilën produkti nuk është përdorë. Kjo kohë llogaritet nga dita e kërkesës së konsumatorit për mënjanimin e mangësisë.

Në rast të mënjanimin të mangësive me zëvendësimin e prodhimit i cili bashkëngjitet ose është pjesë përbërëse e prodhimit për të cilin janë caktuar afatet garancë, garancia kohore për prodhimin e ri fillon të vijojë nga dita kur konsumatori i është porositur produkti mangësia në të cilin është mënjeluar.

AKTIVITETI – GARANCIA E PRODUKTIT DHE TË DREJTAT E MIA KONSUMATORE

Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të kuptojë rëndësinë e garancisë;
- ⇒ të dinë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të mund të zgjidhin problem.

Mjetet mësimore: tabelë, shkumës, ngjyra, flomasterë, hamer.

Vendi i realizimit: klasë dhe vende tjera të përshtatshme.

Kohëzgjatja e aktivitetit: një orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:

Mësimdhënësi parashtron pyetje: „Vallë ndonjëri prej jush ka pasur problem me produktin e blerë dhe si e ka zgjidhë atë“?

Nxënësit këmbëjnë përvojat personale ose përvoja të cilat i kanë mësuar nga prindërit e tyre, familjarë apo miq.

Mësimdhënësi i ndanë nxënësit në dy grupe dhe ua jep problemet vijuese për të parë si ata do të kishin vepruar gjatë zgjidhjes të së njëjtave:

Shembull:

1. Blemë tharëse për flokë e cila pas një muaji u shkatërrua. E dërguam në servis për riparim mirëpo kaluan një muaj e gjysmë dhe ende skemi asnjë përgjigje nga servisi.



2. Si dhuratë mora një mjet për fotografim dhe i njëjti nuk funksionon.



Secili grup e shqyrton problemin e veti cili u është ndarë dhe mundohen të gjejnë zgjidhje për atë. Pastaj zgjidhjet shënohen në tabelë ose hamer. Mësimdhënësi i lexon të drejtat e konsumatorëve për prodhime nën garancë dhe bashkërisht me nxënësit i korrigjon zgjidhjet e tyre.

PYETJE	PËRGJIGJE
Vallë llogarinë fiskale duhet ta ruani së bashku me garancinë dhe fletën e garancisë?	Po, ndryshe nuk do të mundem ta realizoj të drejtën e garancisë.
Në qoftë se keni garancinë për produkt/prodhim të caktuar, ndërsa i njëjti është dërguar në servisim dhe është mbajtur më shumë se 30 ditë, dhe nuk je i informuar për atë se si do të veprosh?	Produkti/prodhimi duhet të kërkoj të më kthehet në afat prej 30 ditë. Në qoftë se i njëjti nuk është rregulluar ose nuk mund të rregullohet, kam të drejtë të kërkoj prodhim të ri.
Vallë do të kërkosh edhe vazhdimin e afatit për garancinë dhe për sa kohë (në qoftë se shitësit nuk i bie ndërmend ta bëjë atë?	Po, gjatë kohës kur produkti ka qenë për tu rregulluar.

DEKLARATA

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

Deklarata është e detyrueshme për secilin prodhim dhe doemos të përmbajë të paktën të dhëna për prodhuesin, përkatësisht emri dhe selia e prodhuesit, importuesit, materialeve prej të cilave është bërë prodhimi, mënyra e mirëmbajtjes dhe përdorimi i prodhimit, si dhe origjina e prodhimit. Këto të dhëna ndonjëherë janë caktuar me dispozita të posaçme varësisht nga ajo se për cilin grup të prodhimeve bëhet fjalë.

AKTIVITETI: DEKLARATA – LETËRNJOFTIMI I PRODHIMIT

Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të kuptojnë rëndësinë e deklaratës;
- ⇒ të mësojnë elementet e deklaratës;
- ⇒ drejtë të mund të veprojnë dhe të sjellin rregulla dhe vendim racional të tregut;
- ⇒ të mund ti njohin dhe realizojnë të drejtat e tyre si konsumatorë.

Mjetet mësimore: prodhime me deklaratë, fotografi të deklaratave, përvoja nga mbishkrimet.

Vendi i realizimit: klasë, qendra shërbyese dhe tregtare, lokale dhe ngjashëm.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit: Mësimdhënësi paraqet deklarata të prodhimeve dhe bën tabelë siç tregohet më poshtë. Më pas mësimdhënësi dhe nxënësit bëjnë analizën e përmbajtjeve nga deklaratat e prodhimeve krahasuar me minimum elementet e nevojshme të caktuara në Ligjin e mbrojtjes së konsumatorëve, duke vënë minus dhe plus në tabelë. Shiko shembullin më poshtë:

PRODHIMI 1		ELEMENTET E DEKLARATËS									
		Emri i prodhimit	Mënyra e mirëmbajtjes	Përbërja	Mënyra e përdorimit	Marka tregtare	Data e prodhimit/afati i përdorimit	Firma/ selia e prodhimit/ tregtari	Rreziku i mundshëm gjatë përdorimit	Deklarata për cilësitë e ndryshuara të prodhimit/pjesët	Deklarata e përputhshmërisë të prodhimit me kushtet në dispozicion
PRODHIMI 2		ELEMENTET E DEKLARATËS									
		Emri i prodhimit	Mënyra e mirëmbajtjes	Përbërja	Mënyra e përdorimit	Marka tregtare	Data e prodhimit/afati i përdorimit	Firma/ selia e prodhimit/ tregtari	Rreziku i mundshëm gjatë përdorimit	Deklarata për cilësitë e ndryshuara të prodhimit/pjesët	Deklarata e përputhshmërisë të prodhimit me kushtet në dispozicion

B) PRODHIME ME MANGËSI – TË DREJTAT DHE VEPRIMET GJATË RASTEVE TË TILLA

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSIT

Cilat të drejta i posedon konsumatori në rast se blenë prodhim me mangësi?

Konsumatorit të cilit i është shitur prodhim me ndonjë mangësi ka të drejtë sipas zgjedhje s së tij të kërkojë: (1) shmangien pa pagesë të mangësive të prodhimit ose kompensim të shpenzimeve të bëra për shmangien e mangësisë; (2) zvogëlimin e çmimit të shitjes; (3) zëvendësimin e prodhimit me markë të njëjtë ose tjetër markë tjetër tregtare, lloj, dizajn industrial ose shenjë për origjinën dhe shenjë gjeografike të prodhimit; (4) prishjen e marrëveshjes, kthimin e shumës së paguar dhe kompensim për dëmin e bërë.

● AKTIVITETI – SI TË VEPROJ KUR BLEJË PRODHIM ME MANGËSI?

Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të njihen me të drejtat të cilat dalin nga Ligji i mbrojtjes së konsumatorëve;
- ⇒ të zhvillojnë ide kritike dhe gatishmëri për zgjidhje praktike të problemeve konsumuese.

Mjetet mësimore: tabelë, posterë, flomasterë.

Vendi i realizimit: klasë.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.



PYETJE	PËRGJIGJE
Kujt i drejtoresh dhe në çfarë afati mund të parashtrohet kërkesa në rast kur produkti/prodhimi ka mangësi?	Kërkesa parashtrohet në organin kompetent të inspektoratit, tregtari ose te distribuesi. Konsumatori sipas dëshirës së tij bën përzgjedhjen se ku do ta parashtrrojë kërkesën. Kërkesa dërgohet me afatin e garanciës (të theksuar në fletën e garancisë), përkatësisht në afat në të cilin prodhuesi ka theksuar se mund të përdoret produkti (i cili vijon nga dita e prodhimit të tij).
Vallë gjatë shfrytëzimit të këtyre të drejtave, konsumatori duhet të dorëzojë diçka, përveç kërkesës, deri te tregtari, distributori ose organi kompetent të inspektoratit?	Konsumatori është i obliguar të bashkëngjese llogarinë fiskale për produktin, përkatësisht vërtetim dhe nëse ekziston garancia atëherë posedon edhe fletë garancie.
Çka në qoftë se produkti nuk ka garanci?	Atëherë konsumatori mund të parashtrrojë kërkesë, në qoftë se mangësitë janë zbuluar në afat prej gjashtë muaj nga dita e dorëzimit të produktit/prodhimit. Pas skadimit të këtyre afateve, konsumatori i humb të drejtat në bazë të produktit me mangësi. Nëse konsumatori dëshiron ta zëvendësojë produktin/prodhimin për produkt me markë të njëjtë tregtare, lloji, dizajni industrial ose shenja e origjinës dhe shenja gjeografike. Tregtari nuk ka të drejtë të paguajë dallimin e produktit në qoftë se ndërkohë ka ndryshuar çmimi i atij produkti.


Rrjedha e aktiviteteve:

Mësimdhënësi i ndanë nxënësit në tre grupe.

Dy grupe trajtojnë problem të caktuar të konsumatorit i cili ka të bëjë me prodhim i cili ka mangësi. Grupi i tretë i ka parasysh të drejtat e konsumatorëve në këtë rast.

Secili grup i cili ka trajtuar një problem konsumatori jep zgjidhje të mundshme të cilat shënohen në tabelë, ose në poster të madh.

Grupi i cili i di të drejtat e konsumatorëve jep vështrim dhe zgjidhje të problemit në fjalë.
Bëhet revizioni i zgjidhjeve paraprake, të cilat u paraqitën në fillim dhe definohen zgjidhje të reja në bazë të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.



Shembuj:

1. Bleva këpucë për të cilat mësova se nuk e depërtojnë ujin, mirëpo pas dy ditëve që i mbajta në kohë me lagështi këpucët i lëshoi ngjitësi.

2. Bleva telefon celular për të cilin më dhanë dokumentacione complete por vetëm sa arrita në shtëpi bateria u zbraz dhe telefoni shpejtë fikej.



C) SJLLJE JO E MIRË NË TREG (PRAKTIKAT MASHTRUESE GJATË SHITJES SË PRODHIMEVE DHE SHËRBIMET)

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

Për përgatitjen e mësimeve rekomandohet t'i lexojë dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve që kanë të bëjnë me reklamimin, si dhe broshurën „Sjellja jo e mirë në treg – si ta njohim atë?“ e cila është hartuar në bazë të ndryshimeve më të reja të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 24/2011).

Çka nënkuptojmë me sjelljen në treg ndaj konsumatorëve?

Sjellja e tregut ndaj konsumatorëve nga ana e subjekteve afariste është secili veprim, lëshim, mënyrë e sjelljes ose kujdesje, komunikimi tregtar, duke përfshirë reklamimin dhe marketingun nga ana e tregtarit, drejtpërdrejtë të ndërlidhur me promocionin, shitja ose furnizimi i prodhimeve dhe shërbimeve për konsumatorët.

Ndalimi i sjelljes së pahijshme në treg

Në ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve ekziston dispozitë e përgjithshme e konsumatorëve me të cilën ndalohet sjellja jo e mirë e në treg. Kjo është gjithëpërfshirëse ose siç njihet „dispozitë ombrellë“, e cila ka për qëllim të përfshijë të gjitha llojet e sjelljes në treg e cila do të llogaritet ose trajtohet si e pasjellshme.

Sjellja e tregut konsiderohet veçanërisht e pandershme në qoftë se është mashtruese ose agresive. Gjithashtu, ekziston listë e sjelljes jo të mirë në treg e cila në të gjitha rrethanat konsiderohet si e pandershme (e ashtuquajtur listë e zezë).

Vallë reklamimi është sjellje tregu? Reklamimi, gjithashtu, paraqet sjellje tregu nga ana e subjekteve afariste dhe paraqet prezantimin në çfarëdo forme dhe lidhje tregtare, biznesin, zejtarinë ose profesionin me qëllim të promovimit të shitjes ose dërgesës të prodhimeve dhe shërbimet.

Çka nënkuptojmë me reklamimin mashtrues? Reklamim mashtrues është çdo reklamim në çfarëdo mënyrë qoftë, duke përfshirë edhe prezantimin e tij, i shpie në hamendje ose plotësisht i shpie në mashtrim, personat të cilëve iu dedikohet dhe e cila për shkak të natyrës së saj mashtruese me të vërtetë do të ndikojë që konsumatori të merr vendim për blerje të atij prodhimi ose shërbimi.

Reklamimi mund të drejtohet në ekzagjerim ose pohime ekzagjeruese lidhur me karakteristikat kryesore të prodhimit dhe shërbimit, në pikëpamje të qasjes të prodhimeve dhe dobisë prej tyre.

Shembuj të reklamimit mashtrues: pohimet për humbjen e kilogramëve për një kohë tepër të shkurtë, parandalim i shpejtë i rënies së flokut ose lehtësimi të dhimbjeve. Hasen edhe reklama që kanë të bëjnë me karakteristikat e prodhimit, për shembull: rreziqet: diçka shitet si prodhim pa rrezik, dhe në të vërtetë nevojiten instruksione të sakta për përdorimin e tij. Gjithashtu, mund të vërehet sjellje jo e mirë tregtare kur jepen informata (përmes caktimit, reklamës, ofertave të ndryshme etj)., për përbërjen e prodhimit të cilat janë të pavërteta, për shembull: pa sheqer, pa aditive. Si shembull mund të theksohen edhe pohimet për pajisje plotësuese dhe shërbime sipas shitjes (zgjidhja e reklamave përmes 24-orëve ndihmë, ndërsa operatori nuk përgjigjet gjatë orarit të natës); korigjim pa pagesë (ndërsa kostoja e transportit të prodhimit llogariten në dërgesën e bërë.)

● AKTIVITETI – VALLË GJITH ÇKA REKLAMOHET ËSHTË E SAKTË?



Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ për të arritur njohuri për reklamën dhe elementet e saja;
- ⇒ të mund të dallojnë reklamën mashtruese nga ajo korrekte;
- ⇒ të zhvillojnë mendim kritik.

Mjetet mësimore: tabelë, postere, flomasterë.

Vendi i realizimit: klasë.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:

Pyetje për nxënësit:

- ▶ Çka kuptojmë me reklamimet dhe ku i hasim ato?
- ▶ Çfarë ndikimi kanë reklamat ndaj konsumatorëve?
- ▶ Si duhet t'i shohë konsumatori reklamat?
- ▶ Vallë reklamat mund të ndikojnë në sjelljen e konsumatorit?

Nxënësve iu prezantohen dy reklama prej të cilave njëra reklamë emitohet gjatë emisionit të fëmijëve, ndërsa tjetra reklamë gjatë kohës të emetimit të ndonjë emisioni popullarizues.

Pyetje logjike të cilat i orientojnë nxënësit:

Në çka dallohen këto reklama ?

Vallë ka më shumë reklama gjatë emisionit për fëmijë ose gjatë kohës së emisionit popullarizues? Pse?

Mësimdhënësi bën tabelë, siç tregohet tabela më poshtë, në të cilën bashkërisht me nxënësit bëjnë krahasim dhe analizë të dyja reklamave në lidhje me:

- **Dëshira dhe nevoja** – vallë prodhimin që dëshiroj ta blejë me të vërtetë më nevojitet? Reklamat do t'iu bindin në atë se me të vërtetë prodhimi iu nevojitet.
- **Gjuha** e cila përdoret në reklamë. Përdorimi i fjalëve bindëse si: më i miri, i freskët, natyror etj.

- Përcjellja e **porosisë kryesore**. Cila është porosia kryesore në reklamë me çka konsumatori do ta mbaj mend ?
- Analiza e **tingujve** të reklamës. Çfarë janë ato?
- Çfarë njerëz marrin pjesë për spotin reklamues? Të rinj, më të rritur?
- Për çfarë **qëllimi grupor** dedikohet reklama?
- **Realitet ose jo?** Vallë është kështu në jetën reale?
- **Në mbarim mësimdhënësi i pyete nxënësit:** Vallë bëni dallime ndërmjet fakteve dhe pohimeve reklamuese? Pastaj zhvillohet debati.

Reklamë	Dëshirë/ nevojë	Gjuhë	Porosia	Tinguj	Pjesëmarrës në reklamë	Qëllimi i grupit për të cilin dedikohet	Realitet ose jo
1.							
2.							

Në pjesën e dytë të aktivitetit i udhëzon nxënësit dy porosi të reklamave të cilat përmbajnë elemente të sjelljes jo të mirë në treg.

Shembull:

1. **Bleni prodhimin tash, veproni menjëherë, prodhimi është me sasi të kufizuar!**

Sa i përket reklamës së parë, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit për të menduar në pyetjet vijuese:

- ▶ Si dëshironi shitësi të veprojë?
- ▶ Çfarë vendimi kërkon të sjellni dhe për çfarë kohe?
- ▶ Në çka duhet të mendoni para se të vendosni?

Zhvillohet diskutim i përbashkët.



2. Blini vaj luledielli, vetëm pa kolesterol!

Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit duke iu parashtruar pyetjet vijuese:



- ▶ Çka është luledielli?
- ▶ Çfarë vaji përmbajnë bimët?
- ▶ Çka është kolesterol? Vallë mund të haset kolesterol te bimët?

Zhvillohet diskutim i përbashkët.

Detyrat për hulumtim: Nxënësit plotësisht stimulohen të hulumtojnë reklama të caktuara dhe të shkruajnë tekst për ato, me ç'rast tekstet ndahen me qëllim që të këmbehen konkluzione të caktuara për seriozitetin, përkatësisht tejkalimin me reklamën. Për shembull: , të analizojnë reklama të famshme të femrave, me personazhe të njohura, reklama gjatë emetimeve sportive ku theksohen vetitë e mira të pijeve të ëmbla ose ushqim me sasi të madhe të sheqerit ose, gjithashtu, reklamë për mjete për dekorimin e flokëve, për kremra të ndryshme për fytyrë të pastër dhe ngjashëm.

● AKTIVITETI – PRODHIMI NUK KTHEHET DHE NUK ZËVENDËSOHET (PRAKTIKA MASHTRUESE)



Qëllimi – nxënësi/nxënësja të dinë të kuptojnë kur bëhet fjalë për sjellje jo të mirë në treg.

Mjetet mësimore: revista me reklama, incizime të disa reklamave në TV (reklama për pushim, me personazhe të njohura etj.), fotografi të bilbordeve, flomasterë, tabelë, letër.

Vendi i realizimit: klasë.

Kohëzgjatja e aktiviteteve: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktiviteteve:

Nxënësit sjellin veshmbathje nga shtëpia me qëllim të mbajnë simulim të ngjarjes së mundshme në shitore për veshmbathje. Secilës veshmbathje nxënësit ja vejnë çmimin. Në mes të „shitores“ qëndron e shkruar me shkronja të mëdha: „Prodhimi i blerë nuk kthehet“. Njëri nga nxënësit është shitës, tjetri blerës. Të tjerët vështrojnë. Nxënësi blerës hyn në shitore e blenë prodhimin dhe shkon në „shtëpi“. Ai konstaton se prodhimi nuk i përshtatet për nga madhësia dhe menjëherë kthehet në shitore. Në shitore shitësi me mikpritje e pret dhe kur konsumatori dëshiron ta kthejë ose zëvendësojë prodhimin, shitësi ia tregon mbishkrimin dhe thotë: „Më vjen keq, por këtu theksohet mirë se prodhimet e blera nuk kthehen e as nuk zëvendësohen me të reja“.

Mësimdhënësi parashtron pyetje:

P. Pse shitësi ka vënë mbishkrim të tillë?

Përgj. Të përpiqet ta shfrytëzojë paditurinë e konsumatorit për të drejtat e tij.

P. Vallë shitësi ka të drejtë?

Përgj. Jo, sepse konsumatori, sipas Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, ka të drejtë ta kthejë prodhimin ose ta zëvendësojë me të ri.

P. Vallë kjo është përvojë e mirë ose përvojë afariste mashtruese?

Përgj. Mashtruese.

P. Çka fiton, dhe çka humbë shitësi me sjellje të këtyllë?

Në afat të shkurtë, shitësi mund t'iu shmanget shpenzimeve për zëvendësim ose kthim të prodhimit te ata konsumatorë që nuk janë të informuar për të drejtat e tyre. Shikuar në afat më të gjatë, shitësi mund të ketë një imazh të keqe te konsumatorët, përkatësisht ata të fillojnë të mos blejnë te ai .

P. Çka imponon shitësi? Si duhet të veprojë konsumatori? Ku duhet të drejtohet dhe si?

Përgj. Shitësi imponon rregullat e veta të lojës të cilat janë në kundërshtim me Ligjin dhe nuk i jep mundësi konsumatorit të thirret në të drejta e tija konsumuese, përkatësisht vihet në rol të caktuar sikur ai të jetë ligj.



Nxënësit deklarohen pas secilës pyetje dhe përgjigje të parashtruar në tabelë. Pastaj, secila nga përgjigjet analizohet dhe shënohet si e saktë ose e pasaktë.

Pyetje	Përgjigje	Numri i përgjigjeve të sakta	Numri i përgjigjeve të pasakta
1			
2			
3			

Rreth gjithë kësaj situatë zhvillohet debati. Mësimdhënësi i arsyeton faktet pasi janë analizuar përgjigjet e pasakta dhe pse janë të pasakta. Krijohet një konkluzion me të cilin të gjithë janë të bindur në procedurat e drejta të përditshmërisë.

Ç) INSTITUCIONET KOMPETENTE

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSIT

Mësimdhënësi mund të përgatitet duke studiuar dispozitat relative të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, por edhe ta shfrytëzojë broshurën „Kush i mbron të drejtat e konsumatorëve?”. Në përmbajtjen tematike „*Të drejtat e konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë*“, theksi është vënë në të drejtat e konsumatorëve dhe si ato mund të realizohen. Në këtë pjesë duhet të udhëzohen nxënësit ku të drejtohen në qoftë se iu rrezikohen të drejtat sa i përket të gjitha temave paraprakisht të përfshira, dhe në çfarë mënyre atë ta bëjnë. Për këtë, në këtë pjesë është e preferuar mësimdhënësi të fokusohet në mënyrën e dërgesës së fletëparaqitjes deri te organi përkatës inspektues. Në këtë rast dhe për këtë pjesë kjo do të ishte Inspektorati shtetëror i tregut (www.dpi.gov.mk)

Si dhe kur duhet thirrur inspektori i tregut?

Inspektorati shtetëror i tregut, punën e vet e bazon në dispozitat e Ligjit të inspektoratit shtetëror të tregut, me të cilin rregullohen kompetencat dhe autorizimet e tij.

Mbikëqyrësi në punën e subjekteve është drejtpërdrejtë i lidhur me obligimin për zbatimin e rregullativës ligjore dhe të drejtat e qytetarit si konsumatorë të mirave materiale dhe shërbimeve.

Qëllimi i mbikëqyrjes të tregut është që të bëhet kontrollimi i rregullt i zbatimit dhe respektimit të rregullativës ligjore në praktikë, me ç’rast rregullohet konkurrenca dhe mbrojtja e konsumatorëve.

Inspektorati shtetëror i tregut ka kompetenca të veprorë, sipas numrit të madh të akteve ligjore dhe nënligjore në më shumë lëmi, siç janë: tregtia, hotelierizmi, turizmi, zejtaria dhe shërbimet personale, mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve, mbrojtja e të drejtave nga pronësia industriale, siguria e prodhimeve. Inspektorati shtetëror i tregut i ka kompetencat për realizimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.

● AKTIVITETI – KUJT DHE SI TË DREJTOHEM?

Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të marrin njohuri për organet kompetente inspektuese për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit;
- ⇒ ti dinë të drejtat e tyre si konsumatorë;
- ⇒ të mund të dinë si të drejtohen në organin kompetent inspektues.

Mjetet mësimore: flomasterë, tabelë, letër, hamerë.

Vendi i realizimit: klasë, vizitë në institucionin përkatës.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.



Rrjedha e aktiviteteve:

Mësimdhënësi shkruan në tabelë:

Në rast se rrezikohen të drejtat tuaja si konsumator, ankesat tuaja mund ti dërgoni në shërbimin inspektues të Organizata për mbrojtjen e konsumatorëve në Maqedoni.

Pastaj pyetë: Cili organ inspektues i mbron të drejtat e konsumatorëve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve? Përgjigja e saktë shkruhet në tabelë.

Mësimdhënësi shkruan kur dhe në çfarë raste konsumatorët do të drejtohen në Inspektoratin shtetëror të tregut: mund ti shënojë edhe numrat e telefonit, adresën dhe postën elektronike etj.

Inspektorati shtetëror i tregut ka kompetenca të veprojë në më shumë lëmi, siç janë: tregtia, turizmi, zëjtaria dhe shërbimet personale, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit, mbrojtja e të drejtave nga prona industriale, siguria e prodhimeve.

Shembull për nxënësit:

Konsumatori ka blerë bluzë në shitore. Pasi arriti në shtëpi konstatoi se prodhimi nuk i përshtatet madhësisë. Megjithatë ai ka ruajtur llogarinë fiskale, menjëherë vajti në shitore, por atje i thanë se nuk ka numër tjetër dhe se nuk mund ta ndërrojnë/zëvendësojnë bluzën me tjetër dhe nuk mund t'ia kthejnë të hollat.

Pyetje për të menduar (logjike):

Si do të veprojë konsumatori në këtë rast?

Çfarë të drejta posedon ai?

Ku do të drejtohet?

Cili është inspektorati kompetent?

Si do të shkruajë ankesë për ta dërguar në Inspektoratin kompetent?

Pasi do t'iu sqarojë nxënësve se organ kompetent inspektues për zgjidhjen e kësaj çështje është Inspektorati shtetëror i tregut, mësimdhënësi i shpërndanë nxënësit në grupe dhe iu jep detyrë të vetë të përpiqen të shkruajnë ankesë deri te Inspektorati shtetëror i tregut.

Secili grup e shkruan ankesën e tij në hamer dhe e elaboron. Mësimdhënësi shfrytëzon ankesë të gatshme në bazë të së cilës dhe bashkërisht me nxënësit bën korrigjime të ankesave të tyre.

2.SIGURIA E PRODHIMEVE

Materialet kryesore për përgatitjen e mësimdhënësit

Për lëmin tematike „Siguria e prodhimeve“ mësimdhënësi duhet të përgatitet përmes njohjes së dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, Ligjit për sigurinë të prodhimeve të kozmetikës („Gazeta zyrtare e republikës së Maqedonisë“ nr. 55/2007), Rregullores për siguri të lodrave për fëmijë të cilat lëshohen në shitje („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/2010 dhe 17/2012) dhe Ligjit për siguri të prodhimeve („gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 33/2006, 63/2007, 24/2011, 51/2011, 148/2011 dhe 164/2013).

Resurset plotësuese

Mësimdhënësi mund ti studiojë dhe shfrytëzojë botimet e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë si:

- broshurat „Siguria e prodhimeve të kozmetikës“, „Siguria e lodrave për fëmijë dhe „Piraterisë dhe falsifikimit“;
- pjesë të doracakut „Edukimi i fëmijës dhe nxënësit si konsumatorë“, në veçanti pjesa e cila ka të bëjë me sigurinë e lodrave për fëmijë.

Botimet e theksuara mund ti hasni në ueb faqen e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë: www.opm.org.mk.

A) PRODHIMET KOZMETIKE

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

Prodhim kozmetike është substancë ose prodhim qëllimi i së cilës është që të përdoret në kontakt me pjesë të ndryshme të jashtme të trupit të njeriut (për shembull: flokë, thonj, dhëmbë , lëkurë etj.), me qëllim të pastrimit, parfumit, ta ndryshojë pamjen e tyre, ti mbrojë ose mirëmbajë në gjendje të mirë. Prodhime të kozmetikës janë: kremat, losionet, gjel dhe vajrat për lëkurë (duar, fytyrë, shputa, etj), maskë për fytyrë, pudër për grim, pudra (pluhur) higjienik sapun tualeti, parfume, deodoransë, preparate për larje dhe dush (gel, yndyra, shkumaë për flokë), mjete për depilim, deodoranse dhe sprej kundër djersës, ngjyra për flokë, llaqe për flokë, shampo për flokë, prodhime për rroje, grim, prodhime për kujdesin e dhëmbëve dhe gojës, prodhime për rrezitje etj.

Prodhim kozmetike i sigurt është ai prodhim, të cilin kur e përdorim në kushte të zakonshme nuk shkakton dëm në shëndetin tonë. Para përdorimit është me rëndësi ta lexojmë udhëzimin për përdorimin dhe ruajtjen e prodhimit të kozmetikës, si dhe vërejtjet ose informatat tjera të dhëna nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i tij i autorizuar. Prodhimi i kozmetikës doemos duhet të përmbajë vetëm substanca (kemikale) që nuk janë të rrezikshme, dhe shumë me rëndësi është të mos i ketë skaduar afati.

Ekziston listë e substancave të cilat **nuk duhet** të përdoren në prodhimet e kozmetikës. Kështu, përdorimi i mjeteve për ngjyrosje lejohet në suaza dhe në kufi të cilat i parashikon Lista e ngjyrave që lejohen të përdoren në lloje të caktuara të prodhimeve kozmetike, me përjashtim të prodhimeve të kozmetikës të cilat përmbajnë ngjyra kryesisht për ngjyrosjen e flokëve.

Per sigurinë e prodhimit të kozmetikës përgjegjës është prodhuesi. Kontrollimin e sigurisë të prodhimeve të kozmetikës e bëjnë laboratorit e akredituara në **përputhje** me dispozitat për akreditim.

Te ambalazha e prodhimeve të kozmetikës duhet të theksohen të dhënat në vijim: emri i prodhimit, lloji i prodhimit, emri dhe adresa e selisë të prodhuesit ose personit juridik i cili është i autorizuar për vënie në qarkullim të prodhimit të kozmetikës, sasia e prodhimit të kozmetikës, afati i kohëzgjatjes, numri serik i prodhimit dhe përbërja e prodhimit të kozmetikës. Këto të dhëna duhet të shënohen në gjuhën maqedonase dhe të duken dhe lexohen qartë.

Mbikëqyrje për atë se vallë zbatohet drejtë Ligji për siguri të prodhimeve të kozmetikës bën Ministria e shëndetësisë, më saktë mbikëqyrësi inspektues mbi realizimin të këtij ligji bën Inspektorati shtetëror për sanitari dhe shëndetësi.



Qëllimet– nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të njihen me elementet kryesore me të cilat duhet të kenë kujdes gjatë blerjes së prodhimeve të kozmetikës;
- ⇒ të mësojnë të kërkojnë informata për sigurinë e prodhimeve;
- ⇒ të mendojnë në mënyrë kritike për pasojat e vendimit të tyre si konsumatorë;
- ⇒ të zhvillojnë aftësi analitike dhe hulumtuese/kërkimore.


Mjetet mësimore: preparate të kozmetikës, deklarata, reklama, mbishkrime, flomasterë, tabelë, letër dhe hamer.

Vendi i realizimit: klasë, shitore për kozmetikë dhe ngjashëm.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:

Mësimdhënësi i përkujton nxënësit se prodhimet e kozmetikës janë pjesë e pashmangshme e përditshmërisë tonë –secili konsumator të paktën një herë në ditë përdor ndonjë prodhim të kozmetikës. Konsumatorët kanë të drejtë kur blejnë prodhime të kozmetikës, të cilat iu garantohen me Ligjin për siguri të prodhimeve të kozmetikës dhe Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve. Pastaj, mësimdhënësi i njofton nxënësit me **elementet kryesore gjatë blerjes të prodhimeve të kozmetikës**. Këto elemente janë paraqitur në fotografinë e mëposhtme.



PYETJE	PËRGJIGJE
Pse është i rëndësishëm udhëzimi për përdorim ?	Veçanërisht është e rëndësishme për prodhime të cilat mund të nxisin ndikime të dëmshme në qoftë se nuk përdoren ashtu siç udhëzohet.
Pse është e rëndësishme mënyra e ruajtjes?	Mënyra e ruajtjes të prodhimit është me rëndësi nga shkak se ruajtja joadekuade mund të shpie në shkatërrimin e prodhimit ose në zvogëlimin e cilësisë së përbërësve të tij. Madje edhe kur prodhimit nuk i ka skaduar afati i kohëzgjatjes, ai, për shkak të ruajtjes jo adekuade mund të prishet dhe të bëhet i papërdorshëm.
Pse është i rëndësishëm afati i përdorimit?	Prodhimet mund të përdoren në afatin e përdorimit. Ai afat është ai në të cilin prodhuesi jep garancisë se prodhimi do ti mbajë dhe ruajë të gjitha vetitë dhe karakteristikat cilësore.
Çka duhet të di për substancat të cilat përdoren gjatë përpunimit të prodhimit kimik?	Të gjitha prodhimet kozmetike të cilat janë krijuar përmes prodhimtarisë konvencionale, përmbajnë kemikale. Pjesë e këtyre kemikaleve mund të jenë të dëmshme për shëndetin. Në deklaratat e prodhimeve, përbërësit të shpeshtën e rasteve janë radhitur sipas sasisë së tyre të prodhimit, që nënkupton se përbërësit e parë në listë është më e përfshirë.

Nxënësit marrin dy prodhime të kozmetikës për qëllime të ndryshme, për shembull: shampo për flokë dhe krem për fytyrë. Pastaj i analizojnë etiketat dhe deklaratat e prodhimeve dhe të dhënat i shënojnë në tabelë:

Prodhime të kozmetikës 1

Udhëzimi për përdorim	Afati i kohëzgjatjes	Mënyra e ruajtjes	Substancat të cilat përdoren gjatë përpunimit të prodhimit?

Prodhime të kozmetikës 2

Udhëzimi për përdorim	Afati i kohëzgjatjes	Mënyra e ruajtjes	Substancat të cilat përdoren gjatë përpunimit të prodhimit?

B). LODRAT DHE SIGURIA E TYRE

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

Mësimdhënësi mund të shfrytëzojë burime të ndryshme të informatave, por preferohet ti lexojë dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, në veçanti pjesa që ka të bëjë me lodrat për fëmijë, si dhe rregulloren për sigurinë e lodrave për fëmijë të cilët lëshohen në qarkullim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/2010 dhe 17/2012).

Çka nënkuptohet me termin lodër për fëmijë?

Lodër për fëmijë është çdo prodhim ose material prodhuar ose dedikuar për lojë të fëmijëve në moshë më të vogël se 14 vjet.

Çka na paraqet lodra për fëmijë?

Si lodra për fëmijë nuk konsiderohen:

- Sende dekorative për manifestime dhe ahengje;
- Prodhime për koleksionerë me kusht prodhimi ose paketimi i tij të kenë shenjë të dukshme dhe që lexohet qartë se prodhimi dedikohet për koleksionerë jo më të ri se 14 vjet.

Shembuj për këtë kategori janë:

- a) Modele të detajuar dhe të sakta, të reduktuara proporcionalisht;
 - b) Komplete për përputhjen e modeleve detaje;
 - ç) Kukulla popullore dhe dekorative dhe prodhime tjera të ngjashme;
 - d) Kopje historike të lodrave dhe
 - dh) Riprodhimi i armës të zjarrit të vërtetë.
- Pajisje sportive (përfshirë edhe roshullet, patina dhe skejtborde dedikuar për fëmijë me peshë trupore më të madhe se 20 kilogram).
 - Çiklistë me lartësi maksimale të ulëses më të madhe se 435 mm.
 - Trotinete dhe mjete tjera transportuese dedikuar për sportim ose udhëtim në rrugë dhe rrugica publike.
 - Automjete në reparte elektrike dedikuar për rrugë ose rrugica ose trotoare.
 - Pajisje të ujit për përdorim në ujëra të thella dhe mjete për të mësuar notin e fëmijëve (goma dhe mjete ndihmëse për not).
 - Radhitëse me më shumë se 500 pjesë.
 - Pushkë dhe pistoleta të cilat përdorin gazin e kompresuar me përjashtim të pistoletave dhe pushkëve me ujë dhe shigjeta për harqe më të gjata se 120 cm.
 - Fishekzjarrë, kapsollë goditëse.
- Prodhime dhe lojëra me sende shigjetash me maje të mprehta, siç janë shigjetat e pikados me maje prej metali.

- Prodhime funksionale arsimore, si për shembull, shporete elektrikë, hekur për hekurosje ose gjësende tjera funksionale të cilat punojnë në tension nominal mbi 24 volt dhe të cilat shiten kryesisht për qëllime mësimore nën mbikëqyrjen e personave të rritur.
- Prodhime dedikuar për qëllime arsimore në shkolla ose në kontekst tjetër pedagogjik nën mbikëqyrjen e personit të rritur , si pajisje shkencore.
- Pajisje elektronike, si kompjuterë personal dhe konsola për lojëra, të cilat përdoren për qasje në softuer interaktiv dhe pajisja e tyre periferike, përveç nëse pajisja elektronike dhe ajo përkatëse periferike nuk janë bërë në veçanti dhe dedikuar për fëmijë dhe kanë vlerën e tyre personale të lodrës për fëmijë, ashtu siç janë bërë kompjuterë special, tastiera, xhojstikë ose timonë.
- Softuer interaktiv, dedikuar për kohën e lirë dhe për argëtim, siç janë lojrat kompjuterike dhe bartësit e tij, si për shembull: CD.
- Thithëse dhe mashtruese për foshnja.
- Truptha të ndriçueshëm për fëmijë.
- Mbushës elektrik për lodra.
- Shtojca moderne për fëmijë të cilat nuk dedikohen për përdorim gjatë lojës.

Cilat janë kërkesat e përgjithshme të sigurisë?

Kur lodra përdoret në pajtim me qëllimin e vet, përkatësisht në mënyrë të parashikuar, duke marrë parasysh sjelljen e fëmijëve nuk duhet ti rrezikojë sigurinë ose shëndetin e shfrytëzuesve ose personave të tretë. Aftësia e shfrytëzuesve edhe kur ajo është adekuate me personat që kryejnë mbikëqyrje mbi ato, merret parasysh veçanërisht në rolin e lodrave që dedikohen për përdorimin nga ana e fëmijëve të moshës nën 36 muaj ose nga grupe tjera të caktuara. Etiketat që janë parashtruar dhe udhëzimet për përdorim që janë bashkëngjitur me lodrën duhet t'ua rekomandojnë shfrytëzuesve ose personave që i mbikëqyrin rreziqet për paraqitjen e dëmit që janë të ndërlidhura me përdorimin e lodrave, si dhe mënyrat për shmangien e rreziqeve të tilla.



● AKTIVITETI – ÇKA ËSHTË E DOBISHME TË DIMË PËR LODRAT ?



Qëllimet – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të mësojnë të bëjnë dallimin ndërmjet asaj që paraqet lodër, e çka jo;
- ⇒ të dinë me cilat rreziqe mund të ballafaqohen ata vetë ose të afërmit e tyre;
- ⇒ të ndërtojnë raporte të rregullta ndaj lodrave;
- ⇒ të aftësohen ti realizojnë të drejtat e tyre si konsumatorë;
- ⇒ të jenë konsumatorë të përgjegjshëm përmes bërjes së ekuilibrit ndërmjet dëshirave dhe nevojave.

Mjetet mësimore: ekzemplarë të ndryshëm të lodrave, flomasterë, tabelë, letër, hamerë.

Vendi i realizimit: klasë, shitore për lodra.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktiviteteve:

Mësimdhënësi jep hyrje dhe i njofton nxënësit me temën përmes parashtrimit të pyetjeve në vijim:

- Për ju çka paraqet lodra?
- Cila ka qenë lodra juaj e parapëlqyer?
- Vallë ju ka ndodhur ndonjë pakënaqësi gjatë lojës me ndonjë lodër?

Plotësoni: Çka nga e përmendura më poshtë është lodër? (S-saktë) (G-gabim)

Lodër është:	S/G: Saktë/Gabim
Çiçibanoz djalli që ndriçojnë	
Radhitëse me më pak se 500 pjesë	
Trotinetë	
Ari prej kadifeje	
Top	
Lojë kompjuterike	

B) PRODHIME TË FALSIFIKUARA

PËRGATITJA PËR MËSIMDHËNËSIN

E dobishme dhe rekomanduese është që mësimdhënësi ti udhëzojë nxënësit që duhet të dinë për prodhimet e falsifikuara dhe prodhimet piraterike. Për këtë qëllim rekomandohet të lexohet broshura „Malli i falsifikuar dhe piraterik“ i Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë, si dhe mbulimi medial për përvojat negative nga përdorimi i prodhimeve të këtilla.

Nën **mallrat pirate** nënkuptohen prodhime të prodhuara në bazë të përvetësimeve joligjore të veprave autoriale ose sendeve të së drejtave të përafërta. Më së shpeshti bëhet fjalë për ekzemplarë të përpunuara në mënyrë jolegale të veprave autoriale (psh.: botim të romanit pa lejen e autorit ose shumëzohet pa pëlqimin e botuesit), përkatësisht, lëndë të së drejtave të përafërta (për shembull., shumëzues të bartësit të tingullit, bartës të ilustrimeve dhe tingullit, filma etj.)

Me termin **prodhime të falsifikuara** nënkuptojmë prodhimet, së bashku me ambalazhën, në të cilën pa autorizim është shënuar marka tregtare identike me markën tregtare regjistruar për prodhime të tilla, ose markë tregtare e cila sipas të gjitha karakteristikave të saja qenësore nuk mund të dallohet nga marka tregtare e regjistruar (për shembull., veshmbathja në të cilën është vënë marka tregtare pa pëlqimin e bartësit për të drejtën e markës tregtare).

Prodhimet e falsifikuara dhe ato piraterie **mund të nxisin dëm të ndryshëm ose përmbushje joadekuate të nevojave të konsumatorëve**, për shembull:

- helmimi nga falsifikimi i pijeve alkoolike;
- paraqitja e alergjive nga detergjente të falsifikuar, shampo dhe prodhime të kozmetikës;
- prania e antibiotikëve në barna për zvogëlimin e temperaturës dhe analgjetikëve dhe zhvillimi i rezistencës të antibiotikëve;
- shitja e pjesëve jocilësore në industrinë e automobilave e cila është shkak i komunikacionit të sigurt dhe paraqitja e fatkeqësive të komunikacionit;
- shitja e prodhimeve teknike pa garancisë që mund ta eliminojnë instalimin dhe të shkaktojnë zjarr;
- me softuer piraterie që është i modifikuar mund të shkatërrohet kompjuteri;
- cilësi e dobët e librave, filmave, muzikës piraterie etj.

Si të mbrohem nga prodhimet e falsifikuara dhe ato piraterie?

Përmes shmangies së:

- blerjes së prodhimeve nga shitës rruge të cilët nuk japin llogari fiskale;
- blerjes së barnave dhe mjeteve ndihmëse mjekësore në tregje të gjelbra;
- blerjes të prodhimeve pa deklarata në gjuhën maqedonase;
- blerjes së mallit me ambalazhe jostandarde;
- marrja dhe instalimi i softuerit pa licencë.

● AKTIVITET – ÇKA DUHET TË DIJË PËR PRODHIMET E FALSIFIKUARA DHE PRODHIMET E PIRATËRISË?



Qëllimi – nxënësi/nxënësja të arrijnë njohuri për prodhimet e falsifikuara dhe piraterisë dhe të kuptojnë se vallë nuk duhet t'i blejnë.

Mjetet mësimore: fllomasterë, tabelë, letër, kamerë, fotografi, video – klipe, kuti të zbrazura.

Vendi i realizimit: klasa.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:

Mësimdhënësi, sipas zgjedhjes së tij, mund të lexojë pjesë nga broshura „Malli i falsifikuar dhe i piratërisë”, apo të paraqet video –material.

Mandej organizohet punëtori për përpunimin e 2 prodhimeve. Sipas detyrës dhe marrëveshjes paraprake kanë sjellur materiale për punë – 25 kuti të zbrazura me madhësi dhe dimensione të njëjta. Përpunojnë 25 prodhime me vizatim plotësisht të njëjtë i cili duhet të jetë shenjë/logo i prodhimit. Megjithatë në disa prej prodhimeve shkruan TOBLERONE ndërsa në tjetrin TOBLERON.

Prodhimet e përpunuara përzihen dhe vendosen në bankë. Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë duhet të merr sa më tepër prodhime TOBLERON, ndërsa grupi tjetër TOBLERONE.

Qëllimi është që të shikohet se në atë përzierje dikush do të merr prodhim të gabuar përkatësisht në vend TOBLER, TOBLERONE apo e kundërta.

Çka duhet nxënësit të mësojnë/njohin? Gjithashtu edhe gjatë kohës së festave dhe frekuentimit në shitore duhet ta shikojnë mirë prodhimin para se ta blejnë!

Plotësoni tabelën

Pyetje	S/G – Saktë/Gabimisht
Duhet të blejë filma nga tregu	
Në rregull është që prodhimi të mos ketë deklaratë në gjuhën maqedonishte	
Komputeri im është pa licencë dhe kjo është në rregull	

D) INSTITUCIONET KOMPETENTE

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSIT

Mbikëqyrje për realizimin e Ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve, Ligji të sigurisë së prodhimeve kozmetike

(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 55/2007), Rregullorja për sigurinë e lodrave të fëmijëve të cilat lëshohen në shitje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/2010 dhe 17/2012) dhe Ligji i sigurisë së prodhimeve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 33/2006, 63/2007, 24/2011, 51/2011, 148/2011, 164/2013) kryejnë organet e caktuara të inspektoratit.

Siguria e lodrave të fëmijëve në pajtim me Ligjin e sigurisë së prodhimeve dhe Rregullorja për sigurinë e lodrave të fëmijëve të cilat lëshohen në shitje është në kompetencë të Inspektoratit shtetëror të tregut dhe Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor.

Prodhimet e falsifikuara janë nën kompetenca të Inspektoratit shtetëror të tregut.

AKTIVITET - KU DREJTOHEM?

Qëllimi – nxënësi/nxënësja të arrijnë njohuri për institucionet të cilat duhet drejtohen nëse hasin në prodhim të pasigurt apo dyshojnë në sigurinë e prodhimit.

Mjetet mësimore: fllomasterë, tabelë, letër, kamerë.

Kohëzgjatja e aktivitetit: 2 orë.

Rrjedha e aktivitetit:

Arsimtari i ndan nxënësit në tre grupe dhe secilit grup problematikë të ndryshme.

1. Grupi i parë: Në një parfumeri kam vërejtur se prodhime të caktuara kozmetike ishin me afat të kaluar. Ku të paraqes?

2. Grupi i dytë: Lodrën që e bleva kishte aromë të çuditshme. Dyshoj se përmban kemikale të caktuara. Ku ta paraqesë?-

3. Grupi i tretë: Në një shitore me gabim, meqë shpejtova, bleva prodhim i cili i ngjante shumë prodhimit që e ble rregullisht. Ishte me ngjyrë dhe etiketë të njëjtë por pak dallohej në emrin. Ku të drejtohem?

Nxënësve ju jepet udhëzim se si bëhet **parashtresa**. Parashtresa duhet ta përmbajë këtë që vijon:

[Emri dhe mbiemri i konsumatorit]

[Adresa]

[Numri i telefonit, kontakti]

Në

[Emri i organit kompetent të inspektoratit, apo Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë]

Të nderuar,


Më _____ në shitoren _____ që gjendet në rrugën _____
bleva _____ për të cilin posedoj llogari të rregullt fiskale.

Prodhimi [përshkruaj se çka ka ndodhur, çka ke vërejtur]

Shpresoj se do t'i kontrolloni këto udhëzime dhe të njëjtave do t'ju përgjigjeni.

Me respekt, _____

Rruga e parashtresës udhëzuar në Organizatën e Konsumatorëve të Maqedonisë



3. SIGURIA E USHQIMIT

Material bazë për përgatitjen e mësimeve

Gjatë përpilimit të lëmisë tematike „Siguria e ushqimit“ arsimtari udhëzohet që ta lexojë Ligjin për sigurinë e ushqimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 157/2010).

Resurset plotësuese

Mësuesi mund t'i shfrytëzojë edhe broshurat e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë dhe broshurat e Agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë në sferën e ushqimit edhe atë: „Shëndeti është i rëndësishëm – çfarë informata duhet të përmbajë përcaktimi i ushqimit?“, „Përcaktimi i ushqimit GMO“ dhe „Udhëzues në Ligjin e sigurisë së ushqimit“.

Këto broshura dhe informata plotësuese mund të hasen në ueb – faqen e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë: www.opm.org.mk dhe në Agjencinë e ushqimit dhe veterinarisë: www.fva.gov.mk.

A) PËRCAKTIMI I DREJTË I PRODHIMEVE USHQIMORE SIPAS LLOJEVE TË PRODHIMEVE

PËRGATITJA E ARSIMTARIT

Përcaktimi paraqet vënien e shenjave të ushqimit apo paketimin e tij si lloj fotografish, vizatimesh, simbole apo tekst përmes të shkruarit, vulosjes, shtypjes, vendosja e ilustrimeve, vizatimi apo mënyra tjetër në shtojcën e paketimit, duke përfshirë edhe etiketa, shenja e një prodhimi dhe ngjitëset apo çfarë do qoftë mënyrë e përcaktimit.

Përmes përcaktimit të prodhimeve fitohen informata të dobishme. Nëse me vëmendje e lexoni, do të kuptoni më tepër për ushqimin që e bleni dhe në atë mënyrë do t'i shmangeni ushqimit dhe përbërjeve të ushqimit për të cilët jeni të ndjeshëm dhe ndikojnë në gjendjen e Juaj shëndetësore. Nëse përsëri hasni në prodhim me afat të caktuar jeni të detyruar që menjëherë ta paraqitni në vendin e blerjes dhe ta informoni Agjencinë e ushqimit dhe veterinarisë.

Përcaktimi duhet t'i përmbajë këto të dhëna themelore vijuese:

- Emri me të cilin shitet prodhimi;
- Listën e përbërësve që përdoren në procesin e prodhimit apo gjatë ripërpunimit të prodhimeve ushqimore;
- Sasi e përbërësve të caktuar apo kategorinë e përbërësve që përdoren në procesin e prodhimit;
- Neto - pesha;
- Afati i kohëzgjatjes;
- Kushtet specifike për ruajtjen dhe kushtet për përdorim;
- Seria (sharzh, parti, lot);
- Emri dhe adresa e prodhuesit dhe importuesit;
- Vendi i prejardhjes dhe burimi i prodhimit;
- Udhëzimi për përdorim;
- Përmbajtja e alkoolit për pije që përmbajnë më tepër se 1,2 vol, përqindje dhe alkool.

Çka tjetër duhet theksuar?

- E konservuar me rrezatim të jonizuar;
- Të paketuar në atmosferë të kontrolluar;
- Origjinë organike;
- E modifikuar gjenetike;
- Përbërës të cilët shkaktojnë alergji te njerëzit;
- Ëmbëlsira shtojcë;
- Përbërje nutritive.

Informata plotësuese dhe të dobishme

- Numri i telefonit të prodhuesit, importuesit, distribuesit për informata plotësuese;
- Menaxhimi i prodhimit, ruajtja, shtyrrja e afatit, riciklimi e ngjashëm;
- Shenja që kanë të bëjnë me mënyrën e prodhimit (të prodhuara me ferr – tregti, shpërblime nga testet e pavarura – laboratorë, nënshkruese të kodekseve etj).

Konsumatori duhet të ketë kujdes për:

Sasinë

Secili prodhim ushqimor duhet të përmbajë informata për sasinë neto të shprehur në 1/ml për lëngje apo g/kg për substanca të ngurta. Mandej sasia neto nuk e përfshin peshën e materialit ku është paketuar prodhimi ushqimor (për shembull. djath 300 g, qumësht 1 l).

Emri i prodhimit

Emri me të cilin shitet prodhimi duhet të jetë i theksuar detyrimisht me qëllim që ta informojë konsumatorin për natyrën e vërtetë të prodhimit.

Përbërësit

Të gjithë përbërësit që i përmban prodhimi duhet të jenë të shënuara në paketim sipas radhitjes së rënies së peshës. Përcaktimi i përbërësve nuk bëhet te pemët dhe perimet e freskëta, uji me gaz, mandej te uthulla, djathi, buteri, qumështi, kremi nëse prodhimi është prodhuar nga një prodhim themelor dhe pije të cilat përmbajnë më tepër se 1,2 përqindje të alkoolit në vëllim.

Afati i qëndrueshmërisë

Afati i qëndrueshmërisë e përcakton periudhën deri kur prodhimi i përmban vetitë e veta specifike gjatë ruajtjes së drejtë dhe magazinimit dhe mbetet sigurt për konsumim. Afati i përdorimit caktohet „përdoret deri më” (për prodhimet të cilat mundën lehtë të prishen, psh. mishi, vezët, prodhimet e qumështit). Nëse konsumatori gjatë blerjes konstaton prodhime me afat të kaluar të përdorimit, nevojitet

Që të reagojë në vendin e blerjes së prodhimit, i njëjti mos të blihet ndërsa për mungesat në përcaktim të informohet Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë. Afati i qëndrimit nuk caktohet te pijet të cilat përbëjnë më tepër se 10 përqindje vëllimi alkool, uthull.

Prodhuesi/importuesi

Prejardhja

Udhëzim për përdorim

Udhëzim për rruajtje dhe magazinim

Informatat nutritive

Këto informata kanë të bëjnë me vlerën energjetike dhe me substanca ushqimore (proteina, yndyrëra, fije ushqyese, vitamina, minerale) të cilat i përmban prodhimi ushqimor.


Konstatime nutritive dhe shëndetësore

Konstatimet nutritive kanë të bëjnë me disa përbërje ushqyese që i përmban prodhimi dhe paraqesin vlerën e tyre energjetike (proteinat, yndyrëra, karbohidrate, fije ushqyese, vitamine, minerale)

Konstatimet shëndetësore

Këto janë konstatime që tregojnë se ekziston relacion në mes prodhimit ushqimor dhe shëndetit të njeriut. “ Vitamina C e zmadhon absorbimin e hekurit”, “ Kalciumi ndikon në funksionin normal të muskujve”, janë shembuj për konstatime të këtilla. Konstatimet nutritive dhe shëndetësore mund të shënohen në prodhim vetëm nëse janë konstatuar në mënyrë shkencore! Konstatimet shëndetësore për atë se prodhimi e përmirëson punën e organeve të caktuara vitale, ose shërben si preventivë për disa sëmundje, përkatësisht shëron disa sëmundje, nuk janë të lejuara përderisa nuk janë shkencëtarisht të vërtetuara.

● AKTIVITET- PËR ÇKA TË KEMI KUJDES, SIDOMOS KUR BLEJMË USHQIM!



Qëllimi – nxënësi/nxënësja ta kuptojnë rëndësinë e sigurisë së ushqimit, dhe të kuptojnë se për çka duhet të kenë kujdes kur blejnë prodhime ushqimore.

Mjetet mësimore: deklarata të mbledhura nga ana e nxënësve gjatë javës së kaluar, hamer, flomaster.

Vendi i realizimit: klasa.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Arsimtari i pyet nxënësit çka do të lexonin së pari nga etiketa e prodhimit ushqimor.


Bën tabelë, gjatë së cilës dy kolonat e fundit (“ Në deklaratë duhet të qëndroj”) i mbulon me hamer.

Pastaj e shpalos kolonën “ Në deklaratë duhet të qëndroj” dhe lexon për secilën pjesë pse ajo është me rëndësi .

Së pari do të lexoj: (Nxënësi numëron, psh afatin e përdorimit, sasinë etj., ndërsa arsimtari shkruan)	Numri i nxënësve që janë përcaktuar se u intereson	Në deklaratë duhet të qëndrojë:	Pse është me rëndësi?
Psh. Afati i përdorimit	14 nxënës nga etiketa së pari do ta lexojnë afatin e përdorimit	Afati i përdorimit	
		Prodhuesi/importuesi	
		Prejardhja	
		Udhëzim për përdorim	
		Udhëzim për ruajtje dhe magazinim	
		Sasia	
		Përbërja	
		Informata nutritive	

PUNA HULUMTUESE

Arsimtari sjell tre lloje të ndryshme të prodhimeve qumështore. Ata nuk duhet të kenë të njëjtin çmim dhe duhet të jenë nga prodhues të ndryshëm. Bën tabelë, gjatë së cilës prodhimet i shënon me P1,P2 dhe P3. Në tabelë shkruan se çka duhet të përmbaj deklaratë e prodhimit me elemente themelore. Pasaj së bashku me nxënësit i kontrollojnë prodhimet dhe shkruajnë + (plus), ose –(minus), respektivisht çka qëndron në deklaratën e tyre, dhe çka jo.



B) FUSHAT E MBROJTJES DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE

PËRGATITJA PËR ARSIMTARIN

Mbikëqyrje në implementimin e Ligjit për sigurinë e ushqimit bën Agjencia për ushqim dhe veterinari, respektivisht Inspektorati i ushqimit. Në kuadër të Agjencisë punon njësia për harxhuesit e cila është e fokusuar në mbrojtjen dhe informimin e harxhuesve në fushën e ushqimit dhe të ushqyerit. Gjithashtu, kjo njësi punon edhe prapësimet dhe ankesat e harxhuesëve. Nëse harxhuesi ka ndonjë problem ose ka vërejtur ndonjë pargullësi të lidhur me prodhimet ushqimore, mund të drejtohet deri te Agjencioni për ushqim dhe veterinari dhe ta arsyetoj prapësimin e vet. Atë mund ta bëjë në numrin e telefonit pa pagesë 0800 3 2222 të Agjencisë për ushqim dhe veterinari të Republikës së Maqedonisë. Në këtë numër mund të paraqitni parregullsi nga fusha e sigurisë së ushqimit, mbrojtja shëndetësore dhe mirëqenien e kafshëve dhe të jepni propozime.

0800 3 22 22



БЕСПЛАТНА ЛИНИЈА
ЗА ПОТРОШУВАЧИ

Paraqitja Juaj do të incizohet, por mund të mbeten anonim. Nëse i leni të dhënat e Juaja (emri dhe mbiemri, adresën dhe numrin e telefonit për kontakt) do të merrni informim me shkrim.

Mund të paraqitni parregullsi edhe përmes formularit elektronik, të cilin mund ta gjeni në ueb lokacionin e Agjencisë për ushqim dhe veterinari:

Kontakt

Forma kontaktuese

Dërgoni e-porosi. Të gjithë fushat me * janë të obligueshme.

Emri *

E-adresa *

Lënda *

Porosia *



Mund ankesën ose prapësimin tuaj ta dërgoni edhe deri te Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë përmes porosisë elektronike, me telefon ose personalisht.

(02) 3179-592



секој работен ден од 10:30 до 14:00 часот

● AKTIVITETI- VËREJTA RRUAJTJE JO ADEKUATE TË PRODHIMEVE USHQIMORE, SI TË SHKRUAJ SHKRESË DERI TE AGJENCIONI PËR USHQIM DHE VETERINARI?

Qëllimi – nxënësi/nxënësja të mësojnë të shkruajnë shkresë dhe ta sqarojnë ankesën e vet.

Mjetet mësimore: hamer, fllomaster.

Vendi i realizimit: klasa.

Kohëzgjatja e aktivitetit: një orë mësimore.



Rrjedha e aktivitetit:

Arsimtari përcakton problem. Në një shitore për prodhime ushqimore harxhuesi vërejti se disa prodhime ushqimore nuk ruhen në mënyrë adekuate. Kur desh të blej çokollatë ajo thaj se ishte e shkrirë krejtësisht. Konsumatori do ta paraqes rastin. Kujt dhe si ti drejtohet?

A) Deri te Inspektorati shtetëror i tregut

B) Deri te Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor

C) Deri te Agjencia për ushqim dhe veterinar

Nxënësit e gjejnë cila është përgjigja e sakt, nën A, B ose C. Përgjigja e saktë është nën C dhe arsimtari u jep udhëzime nxënësëve si të drejtohen.

Nëse nxënësit vendosin të bëjnë paraqitje me shkrim, ata duhet të udhëzohen se patjetër duhet ta respektojnë formën në vijim:

[Emri dhe mbiemri i harxhuesit]

[Adresa]

[Numri i telefonit për kontakt]

Drejtuar

Të respektuar,

Më datë _____ në shitoren _____ e cila gjendet në rrugën _____

bleva _____ për të cilën kam llogari fiskale valide(origjinale).

Prodhimi (përshkruaj çka ndodhi çka vërejte)

Mbetem me shpresë se do ti shqyrtoni këto akuza dhe do të më përgjigjeni për të njejtat.

Me respekt,

4.MBROJTA E TË DHËNAVE PERSONALE

Materijale themelore për pregaditjen e arsimtarit

Gjatë përpunimit të fushës tematike:: „*Mbrojta e të dhënave personale*“ arsimtari udhëzohet që ta përdorë Ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale(“ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005, 103/2008, 124/2010, 135/2011 dhe 43/2014) si dhe fletushkën „ Numri im- bota ime e mbrojtur“ e botuar nga Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale.

Resurse plotësuese

Arsimtari mundet gjithashtu ta vizitoj ueb faqen e Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale ku për së afërmi do të informohet për këtë problematikë (www.dzlp.mk).

PREGADITJA E ARSIMTARIT

Çka është e dhënë personale?

E dhënë personale është çdo informatë që ka të bëjë me personin fizik të identifikuar ose personin fizik i cili mund të identifikohet. Personi i cili mund të identifikohet është personi identiteti i të cilit mund të vërtetohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, sidomos përmes numrit amë të qytetarit ose në bazë të të një ose më tepër cilësive specifike për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mental, ekonomik, kulturor ose social.

Çka është përpunimi i të dhënave personale?

Përpunimi i të dhënave personale është çdo operim ose tërësi e operimeve që bëhen mbi të dhënat personale në mënyrë automatike ose në mënyrë tjetër, siç janë: mbledhja, evidentimi, organizimi, rruajtja, rregullimi ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, shpallja ose në mënyrë tjetër bërja të kapshme, barazimi, kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi.

A është e garantuar mbrojtja e të dhënave personale?

Mbrojtja e të dhënave personale i garantohet çdo personi fizik pa diskriminim të bazuar në përkatësinë e tij nacionale, gjini, bindjet politik ose tjera, gjendja materiale, prejardhja sipas lindjes, arsimimi, prejardhja sociale, shtetësia, vendi dhe lloji i qëndrimit ose çfarëdo qoftë karakteristik tjetër personale.

Operatori telefonik a mundet të mbaj kopje të letërnjoftimit ose pasaportës?

Operatori telefonik patjetër të kërkojë dokument për identifikim personal, por jo edhe të mbaj dhe rruaj fotokopje të të njejtit. Fotokopja mund të mbahet vetëm në bazë të pajtueshmërisë së veçantë.

Operatori telefonik a mund të më dërgojë SMS ose email porosi për promovim të prodhimeve të veta?

Vetëm nëse i kemi dhënë pëlqim për marketing të drejtpërdrejtë. Operatori duhet të na mundësojë që këtë pëlqim ta mundemi ta tërheqim në çdo kohë dhe në mënyrë të thjeshtë.

Inspektim në respektimin e këtij ligji dhe akteve të sjellura në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale bën Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale përmes inspektorateve për mbrojtjen e të dhënave personale.

● AKTIVITETI- SI TI MBROJ TË DHËNAT E MIJA PERSONALE




Qëllimi – nxënësi/nxënësja të njihen se të dhënat e tyre personale janë të mbrojtura me ligj, të mësojnë vet ti rruajnë të dhënat e tyre personale.

Mjetet mësimore: hamer, fllomaster.

Vendi i realizimit: klasa.

Kohëzgjatja e aktivitetit: një orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:



Arsimtari zgjedh dy nxënës të cilët janë të kthyer njëri përballë tjetrit me simulim se janë para kompjuterit. Nëse klasa është e kompjuterizuar dramatizimi do të ketë efekt më të madh. Një nxënës nga anash simulon transferim të porosive me kompjuter.

Nxënësit i vjen porosi me këtë përmbajtje:

„Sistemi i sigurisë na tregon se kenë dashur të qaseni në faqen tonë. Ju lutemi për shkak të sigurisë së qasjes dhe me qëllim të vërtetimit të identiteti tuaj klikoni në linkun në vazhdim delovensajt.com i cili gjendet në anën e djathtë lartë. Kjo është për mbrojtjen Tuaj. Ju lutemi klikoni linkun.“

Arsimtari e pyet nxënësin që e merr porosinë si do të veprojë- a do ta klikoj linkun ose jo. I pyet nxënësit si do të vepronin ata. Pastaj kërkon sqarim. Nëse përgjigja është afirmative- pse?. Nëse përgjigja është jo afirmative- pse?. Përgjigjet shkruhen në tabelë ose hamer.

Arsimtari sqaron se obligimi i çdo faqeje ku përdoruesi i len të dhënat e veta personale – si emër dhe mbiemër, numrin e telefonit, adresën – është mbrojtja e atyre të dhënave. Me përparimin e teknologjisë ka mënyra të shumta që të pamundësohet qasja e jo autorizuar deri te të dhënat personale. Por, çdo herë ekziston rrezik përdoruesi të mashtrohet. Njëra ndër mënyrat më të shpeshta për mashtrim dhe joshjen e përdoruesit ti lë të dhënat e veta personale është e njohur si fishing (phishing). Nis me postën elektronike e cila duket si lajmërim oficial i ndonjë faqeje të cilit i besoni, si ndonjë bankë ose ndërrmarje. Pastaj kërkojnë ti lëni të dhënat personale, kurse ata më tutje përdoren për vjedhjen e identitetit. Këto porosi shpeshherë mund të njihen sipas mënyrës se si janë shkruar dhe nuk rekomandohet që të hapen.

5. TË DREJTAT DIGJITALE

Materiale themelore për përgatitjen e arsimtarit

Gjatë përpunimi të fushës tematike „Të drejtat digjitale“ arsimtari udhëzohet që ta konsultoj Ligjin për komunikime elektronike si dhe Ligjin për tregti elektronike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 133/2007 и 17/2011).

PËRGATITJA PËR ARSIMTARIN

Teknologjia informatike dhe komunikative ka ndikuar shumë për ndryshimin e shprehive dhe sjelljeve të harxhuesëve. Teknologjit digjitale të avansuara mundësuan mënyra të reja të blerjes së prodhimeve ose pranimit të shërbimeve, reklamimin, pagesa etj. Mirëpo, vallë kjo teknologji e re çon deri në shkeljen e të drejtave themelore të harxhuesit dhe të drejtave të njeriut? Në pyetje sigurisht se është e drejta e mbrojtjes së të drejtave personale, privatësisë dhe sigurisë. Ne patjetër të sigurojmë rrethinë ku të drejtat e harxhuesve në botën digjitale nuk do të shkelen. Nga këto arsye mundohemi të ju japim sa më shumë informata dhe njohuri harxhuesëve me qëllim që ata më lehtë të gjinden në rrethinën digjitale ku ata duhet të ndjehen të sigurtë dhe garantuar me kontroll të tërësishme të të dhënave personale të privatësisë. Për këtë duhet të vendosen rregulla të obligueshme në praktikën e tij digjitale me nivel të lartë të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Tregu digjital duhet të jetë i rregulluar ashtu që të mundësoj zgjedhjen e çdo problemi në mes tregtarit dhe harxhuesit. Gjithashtu duhet të sigurohet baraspeshë në mes të drejtave digjitale të harxhuesve dhe bartësve të të drejtave të pronës intelektuale. Tregjet digjitale patjetër duhet të sigurojnë konkurrencë të shëndoshë dhe kualitet të shërbimeve, përmes tregtisë së ndershme dhe transparente on-line.

Më poshtë janë përmendur të drejtat on-line ose digjitale të qytetarëve.

1. E drejta për internet qasje. Çdonjëri patjetër duhet të ketë të drejtën e qasjes në internet respektivisht në rrjetet elektronike dhe komunikative i cili duhet të jetë kualitativ dhe i kapshëm. Të miturit duhet të jenë të mbrojtur nga përmbajtjet të cilat mund t'ju shkaktoj dëm dhe të ndikoj në zhvillimin e tyre psikofizik dhe moral. Përmbajtjet që kanë urrejtje, nxisin dhunë ndaj një race, gjinie, religjioni ose nacionaliteti duhet të ndalohen . Qytetarët gjithashtu duhet të jenë të mbrojtur nga spas porositi, d.m.th komunikime të pa kërkuara përmes SMS, MMS, ose postës elektronike.

2. E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale. Qytetarët kanë të drejtën e besueshmërisë të porosive të veta elektronike dhe të dhënave personale. Kur ndonjë rrjetë kërkon të dhëna personale të përdoruesit ai duhet të jep pëlqim. Qytetarët kanë të drejtën e qasjes së të dhënave të tyre personale të cilat rruhen në bazën e të dhënave.

3. Të drejtën për haresë. Qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre të pavërteta, jo të plota ose në mënyrë jo ligjore të fituara të fshihen ose të bllokohen.

4. E drejta e sigurisë. Patjetër të garantohet siguri në rrethinën digjitale duke e kyçur edhe kontrollin efikas mbi të dhënat personale dhe rruajtjen e privatësisë.

● AKTIVITETI – BOTA IME DIGJITALE – A DI SI TË SILLEM?



Qëllimi – nxënësi/nxënësja të mësojnë vetë të kujdesen dhe ti mbrojnë të drejtat e tyre digjitale.

Mjetet mësimore: hamer, fllomaster.

Vendi i realizimit:klasa.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:

Arsimtari së pari parashtron pyetje të paraqitura në tabelë, dhe pastaj i përmbledh përgjigjet me PO dhe JO. Pjesa e këshillave është e mbuluar me hamer. Pas përmbledhjes së përgjigjeve me PO dhe JO, arsimtari ua lexon nxënësve pjesën me këshillat.

PYETJE	NUMRI I PËRGJIGJEVE		KËSHILLAT
	PO	JO	
Deri më tani a ia ke besuar fjalëkalimin e postës tënde elektronike ose të rrjeteve sociale ndonjë shoku ose farefisi etj?			Asnjëherë askujt mos ia zbulo fjalëkalimin, bile edhe kur bëhet fjalë për shok shumë të afërt. Shoku mund të bëhet ish shok dhe t'ua zbuloj fjalëkalimin tënd personave tjerë. Fjalëkalimin tënd mundet ta din vetëm prindërit e tu.
A e përdor vazhdimisht të njëjtin fjalëkalim?			Ndërro fjalëkalimin më shpesh sepse dikush pa dashje e ka parë.
A klikon lehtë në lajmërimet për ndryshim të fjalëkalimit, paraqitje, regjistrim etj?			Ke kujdes gjatë klikimit të çfarëdo informate e cila të paraqitet gjatë kërkimit në internet .
A është kompjuteri yt i mbrojtur?			Ke kujdes kur e shkruan fjalëkalimin. Mbroje kompjuterin nga viruset.
GJITHSEJT PËRGJIGJE			

● AKTIVITETI- IDENTITEI IM NË RRJETET SOCIALE

Arsimtari në hamer bën një profil të paramenduar në Facebook me të gjitha të dhënat e mundshme personale, duke kyçur edhe fotografi dhe statuse. Hameri është i vendosur në dërrasën e zezë.



Arsimtari pyet:

1. Si e përjetoni këtë profil?
2. A do ta pranoni për shok dhe për sa kohë do vendosni ta pranoni për shok?
3. A mendoni se ky profil ka lënë shumë të dhëna për vete?
4. A ka lënë tepër fotografi personale?
5. A mendoni se duhet të shpallet statusi i tij i dashurisë dhe pse?
6. A mendoni se ka tepër informata për atë se ku gjendet për momentin?
7. Çka mendoni vallë ai ka paraqitur një profil të rrejshëm në internet?
8. Çka mendoni për prezantimin e rrejshëm? A mund kjo të jetë e rrezikshme?

Nxënësit përgjigjen për atë se çka ju pëlqen dhe çka jo.

Zhvillohet bisedë.

Këshilla të arsimtarit në drejtim të krijimit të identitetit personal në internet :

- Mendo për këtë: Kush je ti në profilin tënd në Facebook!
- Kush të njeh?
- Kur prezantohesh, ke kujdes për atë si të tjerët të përjetojnë dhe çka mendojnë për ty.
- Mos bën prezantim të rrejshëm dhe mos gënjej për vete.
- Duhet ta marrish përgjegjësin për atë se si prezantohesh .
- Mendo se si sjellja jote mund të ndikoj te familja jote.
- Mos lë shumë informata për vete, sidomos jo personale.
- Mos vendos fotografi të cilat janë shumë personale.
- Vendose emrin tënd në internet dhe kërko se cilat informata për ti gjenden në internet

6. EFIKASITETI ENERGJETIK

Materialet themelore për përgatitjen e mësimeve

Për njësinë tematike „Efikasiteti energjetik“ është shumë i shkruar dhe arsimtari mund të gjen literaturë të pasur. Njëkohësisht ashtu edhe Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë ka botuar disa publikime me temë, në lloj të broshurës, kënd argëtimi dhe tekste në buletin Konsumatorë. Këto materiale arsimtari mund t'i gjenë në ueb-faqen e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë: **www.opm.org.mk**.

PËRGATITJA E ARSIMTARIT

Rëndësia e efikasitet energjetik shikohet në faktin se siguron nivel të njëjtë të energjisë duke shfrytëzuar sasi më të vogla të lëndëve fosile djegëse, rëndësia e shfrytëzimit efikas të energjisë është shumë e pranueshme në botë. Përdorimi i zvogëluar i lëndëve fosile është me rëndësi esenciale për zvogëlimin e misioneve të gazrave të cilët shkaktojnë efekt në kopshtin e qelqtë dhe kontribuojnë kah ngrohja globale.

Çka është efikasiteti energjetik?

Efikasiteti energjetik është përdorimi përkatësisht shpenzimi i më pak energjive për prodhimin apo shërbimin e njëjtë. Mënyra më e mirë që të kuptohet kjo ide është sipas shembullit – nëse ndonjë pajisje elektrike, si frigoriferi apo lavatrigja janë të shkëmbyera me model më efikas, atëherë pajisja e re do ta sigurojë shërbimin e njëjtë por do të harxhojë më pak energji elektrike. Efikasiteti energjetik kursen energji, të holla dhe i zvogëlon misionet e gazrave të cilët e ndotin atmosferën.

Masat më të zakonshme dhe më të zbatueshme për efikasitetin energjetik janë:

a) Ndërtimi i izolimit të ngrohtësisë

Izolimi i nxehtësisë i zvogëlon humbjet e ngrohtësisë në sezonin e ngrohjes e mban ngrohtësinë Në hapësirat ndërsa në verë nuk lejohet ngrohtësia e jashtme të hyjë në brendinë e hapësirës banesore.

b) Ndërimi i dritareve dhe dyerve

Dritaret, dyert dhe ndriçueset janë pjesë integrale e objekteve të banimit. Nëse nuk kënaqin kërkesat e caktuara dhe janë të montuara në mënyrë joadekuate, mund të jenë shkak i humbjeve të rëndësishme të ngrohtësisë, kondensimi, myku, kondensimi dhe komforti jo i mirë në shtëpi.

I montuar drejt, i ri, prodhim energjetik efikas:

- e zvogëlon konsumimin e energjisë dhe kursen të holla;
- e rrit komfortin;
- e zvogëlon kondensimin e qelqit gjatë kohës së ftohtë;
- e zvogëlon depërtimin e zhurmës dhe pluhurit nga jashtë.

Zëvendësimi i dyerve dhe dritareve të vjetra me ata me efikasitet energjetik, në varësi nga numri i njësive të zëvendësuara, gjendja e tyre, shkalla e mbrojtjes, në varësi nga numri i njësive të zëvendësuara, gjendja e tyre, shkalla e mbrojtjes, në varësi nga numri i njësive të zëvendësuara, gjendja e tyre, shkalla e mbrojtjes që e ofroj që e ofrojnë, mesatarisht kursen rreth 10% në harxhimin e energjisë

c) Futja në përdorim e ndriçimit energjetik efikas

Më shumë amvisëri harxhimit e energjisë elektrike për ndriçim mund ta zvogëlojnë për 50 % ose më tepër përmes për 50 % ose më tepër përmes për 50 % ose më tepër përmes aplikimit të poqeve elektrike me efikasitet energjetik ose teknologji më efikase. Poqe fluorescente kompakte (CFL), dioda që emetojnë dritë (LED) dhe poqe fluorescente – janë poqe të cilat mundësojnë ndriçimin e hapësirës me harxhim më të vogël të energjisë elektrike. Mundësi tjetër efektive janë edhe gypat ndriçuese të cilat e përfshin dritën e ditës dhe e dërgojnë kah pjesët më të errëta të hapësirës.

Ndriçimi efikas dhe efektiv:

- siguron nivel të lartë të komfortit vizual;
- përdor dritën natyrale; siguron ndriçim më të mirë sipas qëllimit;
- siguron fleksibilitet përmes pajisjeve kontrolluese;
- ka nivel të ulët të harxhimit.

ç) Blerja e pajisjeve elektrike me nivel të lartë energjetik

Etiketa me klasën energjetike mund të shihet në këto pajisje të amvisërisë:

- frigoriferi
- ngjirës;
- makina për larjen e rrobave;
- tharësja e rrobave;
- lavatriçja;
- klimatizerët.

Etiketa për klasën energjetike, e tregon klasën e pajisjes dhe jep informacione për harxhimit e energjisë elektrike. Duhet të zgjedhet pajisje me klasë të lartë. Çmimi i pajisjes, së bashku me harxhimet për punën e tij japin pasqyrë më të qartë, respektivisht pasqyrë për harxhimet e përgjithshme të pajisjes.

Sa më e lartë të jetë klasa energjetike e pajisjes, aq më i madhe është efikasiteti energjetik. Në kolonë të veçantë është paraqitur harxhimi i përgjithshëm i energjisë në kWh (kilovat orë) në nivel vjetor. Nëse në disponim ka dy pajisje adekuate me klasë energjetike të njëjtë, duhet të zgjidhet ai me harxhim më të vogël të energjisë elektrike në nivel vjetor.

Televizorët, lojërat elektrike, video, CD, DVD pleer-ët dhe pajisje tjera audio-vizuale, pastaj skenerët ose printerët (shtypësit), mund të mos kenë etiketë për klasën energjetike dhe harxhim të energjisë.

Prapë se prapë, në një amvisëri moderne, harxhimi i përbashkët i energjisë elektrike i të gjitha këtyre pajisjeve është i madhe dhe mund ta tejkalon harxhimit e të gjitha pajisjeve tjera të teknikës së bardhë. Televizor me ekran të madh i cili përdoret gjashtë orë në ditë, mund të prodhojë gjysëm ton emisione të gazrave të dëmshëm për rrethinën (më tepër se një frigorifer). Çkyçni pajisjet të cilat nuk përdoren, mos i leni të punojnë në stand by sepse atëherë ata harxhojnë energji elektrike.

ç) Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë

Burimet rinovuese të energjisë për amvisëritë janë: energjia diellore, energjia e erës, energjia e biomasës dhe pompave të nxehtësisë. Të njëjtat mund të përdoren veç e veç ose të kombinuara.

● **AKTIVITETI – ÇKA DUHET TË DIMË PËR EFIKASITETIN ENERJETIK?**

Qëllimi – nxënësi/nxënësja të njoftohen me efikasitetin energjetik, si mund ta aplikojnë në shtëpi dhe në jetën e përditshme.

Mjetet mësimore: tabela, postere, flomaster, maketa të shtëpisë .

Vendi i realizimit: klasa.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore.

Rrjedha e aktivitetit:

Arsimtari sjell maketë të shtëpisë ose vizaton shtëpi në formë të maketës. Nxënësëve u jep detyrë të mendojnë si ta bëjnë shtëpinë energjetikisht efikase me më tepër ide. Nxënësit duhet të nisin nga jashtë, e pastaj të vazhdojnë brenda (psh. Dritaret, dyert, si do ta furnizojnë shtëpinë dhe me çfarë pajisje të amvisërisë, çfarë ndriçimi do të vendosin etj).

Shembull: Arsimtari pyet se çka do të bëjnë me pullazin. Nxënësit mendojnë dhe propozojnë ai të izolohet. Arsimtari pyet çka tjetër mund të vendoset në pullaz. Nxënësit propozojnë të vendoset kolektor solar (i diellit) .

Arsimtari vazhdimisht i motivon nxënësit të japin ide që në fund kur do të mbarojnë ti plotësojë mendimet e tyre.



7. EDUKIMI FINANCIAR

Materiale themelore për përgatitjen e arsimtarit

Fusha tematike “ Edukimi financiar” është fushë relativisht e re, arsimtari duhet të përpiqet të gjej materialet e fundit në internet të cilat mund ti ndihmojnë gjatë krijimit të aktiviteteve të lidhura me këtë temë. Organizata e konsumatorëve e Maqedonisë ka shkruar për edukimin financiar disa herë në revistën “ Harxhues”, dhe ka botuar infotekën “ Shërbimet financiare”. Këto materiale mund të shihen në ueb faqen e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë: www.opm.org.mk.

PËRGATITJA E ARSIMTARIT

Tregu financiar në Republikën e Maqedonisë bëhet më dinamik, ofrohen prodhime dhe shërbime të reja, kurse konsumatorët në Maqedoni shpeshherë nuk janë në mënyrë adekuate të njohur me rregulativën ligjore, shërbimet e sigurimeve dhe investimeve si dhe të atyre të shoqatave të lisingut. Kjo ndikon që të paraqiten probleme kur konsumatorët tentojnë të sjellin vendim të drejtë për zgjedhjen e shërbimit financiar dhe të ofruesit të së njëjtit.

Si rezultat i njohjes jo të mjaftueshme të shërbimeve dhe kushteve në të cilat ata ofrohen, si dhe mungesës së informatave tjera të rëndësishme, konsumatorët shpeshherë e zgjedhin ofruesin e shërbimit financiar vetëm në bazë të reklamave, bisedës që e kanë bërë me ofruesin, kurse shumë shpesh gjatë tërë jetës së tyre përdorin vetëm një ofrues të shërbimeve, psh. Banka, kompania e sigurimeve etj. Gjithashtu, vërehet se qytetarët nuk posedojnë edukim të mjaftueshëm financiar kur hasen me të dhëna më të mëdha financiare. Për atë është e nevojshme që vazhdimisht të punohet në fushën e avancimit të edukimit të konsumatorëve në përdorimin e shërbimeve financiare, por edhe futjen e elementeve të menaxhimit të mirë dhe transparent në informim nga ana e ofruesve të shërbimeve financiare.

Prej moshës së re fëmijët dalë ngadalë bëhen të vetëdijshëm për atë se çka mund të blihet me paratë e disponueshme. Me rëndësi është të zhvillohet edukimi i tyre financiar që të mund të fitojnë korrelacion më të mirë mes nevojave dhe dëshirave, që të kenë qëndrim të vetin kur blejnë prodhime dhe harxhojnë para. Ashtu do t'ju ndihmohet që të bëjnë zgjedhje më të mirë, pikërisht të sjellin vendime të mira.

● AKTIVITETI- A MUND TË MENAXHOJ ME PARATË?

Qëllimi – nxënësi/nxënësja:

- ⇒ të zhvillojnë qasje të drejtë ndaj parave dhe harxhimeve ;
- ⇒ të aftësohen drejtë ta planifikojnë dhe kursejnë buxhetin;
- ⇒ të zhvillojnë interes për kyçjen në menaxhimin me buxhetin familjar;
- ⇒ të zhvillojnë aftësi për menaxhim me buxhetin;
- ⇒ të dallojnë luksin nga nevoja.

Mjetet mësimore: katalogje/ material propagandues nga shitoret, letër, hamer, fllomaster.

Vendi i realizimit: klasa, me vizita të shitoreve ose qendrës shërbyese.

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore dhe aktivitete hulumtuese jashtë mësimit.



Rrjedha e aktivitetit:

Mundë të organizohen punëtori për nevojat e së cilës arsimtari i ndan nxënësit në tre grupe. Grupit të parë “ i ndanë” shumë prej 5000, 00 denarë dhe e udhëzon ti shpenzoj për rrobe. Grupës së dytë “ i ndanë” 4000,00 denarë për ti harxhuar për prodhime ushqimore, kurse grupës së tretë “ i ndanë” 200.00,00 denarë ti shpenzojë duke blerë mobilje të nevojshme për pajisje të dhomës së tinxherëve. Gjatë asaj, grupet mundet të përdorin internet katalogjet, për ti hulumtuar çmimet e prodhimeve.

Para se ta nisin zgjedhjen, arsimtari i udhëzon nxënësit:

KENI KUJDES!

- ▶ Cilëve lëndë gjatë zgjedhjes u japim përparësi?
- ▶ Cilët lëndë mund ti llogarisin si të patjetërsueshme? Cilët si luksoze?

Nxënësit punojnë dhe e plotësojnë tabelën:

Prodhimi	Burimi i informatës (psh. shitoret..)	Çmimi
Bluza	Katalogu, butiku...shitore	


Pas zgjedhjeve të bëra dhe plotësimit të tabelave arsimtari pyet:

- Vallë keni pasur vështirësi që të mos dilni nga kornizat e buxhetit të paraparë?
- Vallë shikuat në disa vende?
- Vallë keni menduar që të vendosni se çka do të bleni?
- Në çka mendoni më tepër?
- Vallë kishte gjëra që i keni konsideruar si luksoze?
- Cilat prodhime i keni konsideruar si të domosdoshme?

Në fund arsimtari pyet se a i kanë mbetur para ndonjërës grup? A ja dolën të kursejnë? Ata para vendosen në kasë. Hapet diskutim pse ndonjëri grup ka arritur të kursej më së shumti.

Pastaj, luten nxënësit t'i shpërndajnë termet që janë numëruar më poshtë në tabelë, në bazë të perceptimit të tyre të prodhimeve si luks ose nevojë.

Ushqim	Pajisje muzikore	Telefon celular
Mjete higjienike	Tablet	Motor
Telefon	Kompjuter	
Gardërobë	Libra	
Zbukurim		



LUKS	NEVOJË

Arsimtari hap diskutim me nxënësit dhe ju ndihmon të njohin, çka për ata do të ishte luks, dhe çka nevojë.

Kjo është vetëm një shembull i aktivitetit, kurse a mund të organizohen edhe aktivitete tjerë, varet prej arsimtarit dhe interesit të nxënësve. Psh. Punëtori për simulim të prodhimit dhe harxhimit; punëtori kreative, planifikimi për harxhimin e parave për blerjen e mjeteve për shëtitje, mësimi në teren, pushime dimërore, pushime verore, ekskursion, aktivitete humanitare.

Mund të përpunohen projekt-detyra grupore me ide dhe interes për nxënësit.

8. LOJRA SHPËRBLYESE DHE BLERJE PËRMES INTERNETIT

Materialet themelore për përgatitjen e arsimtarit

Fusha tematike “ *Lojërat shpërblyese dhe blerja përmes internetit*” Njësia tematike „Lojërat shpërblyese dhe blerje përmes internetit“ është gjithashtu relativisht një lëmi e re – me paraqitjen e teknologjisë moderne paraqitet edhe nevoja për edukim më të mirë të konsumatorëve, veçanërisht më të rinjtë për të gjithë aspektet, e e-tregtisë.

Mësimdhënësi duhet ta hulumtojë material përmes kontrollit të dispozitave ligjore të cilat i rregullojnë lojërat shpërblyese dhe blerjen përmes internetit. Përveç Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, mësimdhënësi duhet ta mësojë edhe Ligjin për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese dhe Ligji për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 24/2011, 51/2011, 148/2011, 74/2012, 171/2012, 27/14 и 139/14; U.nr. 53/2011).

Resurset plotësuese

Mësimdhënësi gjatë përgatitjes mund t'i përdor edhe informatat e shpallura në ueb faqen e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë (www.opm.org.mk), kryesisht edhe veprën Kontratë në largësi prej broshurës „Të drejtat e konsumatorëve të cilat dalin nga marrëveshjet specifikuuese“.

A) LOJËRAT SHPËRBLYESE

PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSIT

Me paraqitjen e teknologjisë moderne janë paraqitur edhe më tepër lloje të lojërave shpërblyese ndërsa i hasim të theksuara në ambalazhet e prodhimeve, në shitoret ku bëjmë tregti, si dhe me SMS apo paraqitje. Organizuesi i lojërave shpërblyese duhet t'i theksojë kushtet për pjesëmarrje dhe rregullat e lojës në më së paku në një gazetë ditore para fillimit të lojës shpërblyese, që konsumatori të njihet me të njëjtat. Organizuesi duhet t'i theksojë të gjitha informatat siç janë: emri i tregtarit i cili është organizator i lojës, kohëzgjatja e lojës, shpërblimet, emri i prodhimit apo shërbimet për shkak të ndonjë reklamë organizohet loja, kushtet për pjesëmarrje etj. Kohëzgjatja e lojës shpërblyese nuk mund të jetë më e gjatë nga një vit kalendarik.

Organizatorët e lojërave të fatit dhe lojërave shpërblyese duhet të marrin licencë të cilën e jep Ministria e Financave ndërsa organizimin jo të autorizuar dhe pjesëmarrjen në këto lojëra të tilla fati është e dënuar me ligj. Personat mbi 18 vjet nuk guxojnë të marrin pjesë në çfarë do lloj lojëra fati.

Konsumatorët duhet të dinë nëse marrin pjesë në lojë të caktuar fati dhe marrin shpërblim, tregtari përkatësisht. Organizuesi i lojës shpërblyese duhet ta dorëzojë shpërblimin në afat prej 8 ditë nga momenti kur loja ka përfunduar apo fituesi ka qenë i njohur.

Gjithashtu, shpesh ndodhë të organizohen lojëra shpërblyese për të cilët nuk janë të informuar qytetarët mandej pa menduar bëhen pjesë e të njëjtave kur do të marrin SMS porosi apo thirrje dhe do t'ju përgjigjen të njëjtave. Nxënësit duhet të mësojnë se si të veprojnë kur në telefonat celular do t'ju arrijë SMS porosi për pjesëmarrje në lojë shpërblyese. Në kësi rasti ata duhet menjëherë t'i informojnë prindërit e tyre dhe provajder celular dhe të informohen se si mundën t'i tërheqin SMS porositë e tyre që të mos bëjnë shpenzime plotësuese.

Lojërat shpërblyese në dhe lojërat në bastore, të cilat refuzohen në ueb faqe të locuara jashtë Republikës së Maqedonisë dhe për të cilën pjesëmarrje nevojitet pagesë e mjeteve përmes internetit të neki nuk janë të ndaluara me Ligj dhe përdorimi i të njëjtave dënohet.

AKTIVITET – UNË SI PJESËMARRËS NË LOJËN SHPËRBLYESE

Qëllimi – nxënësi/nxënësjë të dijnë t'i njohin llojet e lojërave shpërblyese, veçanërisht ata të cilat janë të sigurt për pjesëmarrje nga ata të cilët mundën të shkaktojnë humbje financiare.



Mjetet mësimore: fletushka nga lojërat shpërblyese, lojëra nga supermarketet, fragmente nga gazetate.

Vendi i realizimit: klasa.

Kohëzgjatja e aktiviteteve: dy orë mësimore dhe kohë për hulumtim të lirë.

Rrjedha e aktivitetit:

Merren si shembull dy loja shpërblyese të cilat janë reklamuar në gazetat ditore apo revista. Mësimdhënësi pyet:

Vallë dikush prej jush ka marrë pjesë në lojën shpërblyese?

- Vallë pse?
- Çfarë interesi ka zgjuar loja shpërblyese?
- Vallë keni lexuar diçka në lidhje me lojën shpërblyese para se të vendosni të inkuadroheni?
- Çka lexuat në lidhje me lojën shpërblyese?

Ai u jep informata nxënësve në normat ligjore për realizimin e lojës shpërblyese siç janë:

- Emri i prodhimit që reklamohet me lojë shpërblyese
- Emri i tregtarit i cili e ka organizuar lojën shpërblyese
- Emri i lojës shpërblyese
- Kushtet për pjesëmarrje në lojën shpërblyese
- Rregullat e lojës së lojës shpërblyese
- Shpërblimet
- Kohëzgjatja e lojës shpërblyese

Nxënësit i shikojnë lojërat shpërblyese para vetes dhe përpiqen t'i njohin elementet të cilat janë të detyrueshme për organizimin e lojës shpërblyese. Arsimitari pyet se vallë në lojën të cilën nxënësit e kanë para vetes mungon ndonjë prej këtyre elementeve dhe i lut nxënësit të kontrollojnë.

Pyetje për diskutim:

- Vallë lojërat i plotësojnë normat ligjore për realizimin e lojës shpërblyese?
- Vallë do të kishit marrë pjesë në lojën shpërblyese?
- Tash pasi i dini normat ligjore për organizimin e lojës shpërblyese vallë mund të rikujtoheni për ndonjë lojë shpërblyese e cila nuk i plotëson të njëjtat?

C) BLERJE PËRMES INTERNETIT

PËRGATITJE PËR MËSIMDHËNËSIN

Ekspansioni i teknologjisë moderne ka miratuar edhe numër të zmadhuar të mundësive për kalimin e shitoreve të ndryshme mbarë botën. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë mundësi ma kartelat debitore dhe kreditore nga bankat e Maqedonisë të blejnë prodhime nga pothuajse të gjithë shitoret e internetit në botë.

Gjatë tregtisë me internet me rëndësi është që nxënësit të jenë me disa punë të njohura me disa punë që janë me rëndësi të posaçme që të mund të bëjnë zgjedhje të mirë, të sigurt dhe të drejtë gjatë blerjes:

Gjatë blerjes në internet është e nevojshme kartela debitore apo kreditore për të cilin shfrytëzim duhet patjetër prindi të jep pëlqim dhe përdorimi i kartelës të jetë nën mbikëqyrje të prindit. Ekzistojnë aplikacione të shumta dhe ueb – faqe të rrejshme të cilat janë të krijuara pikërisht për vjedhjen e të dhënave në këto kartela, kështu që që hap i gabuar do të ketë kuptimin e dëmit të madh financiar. Përdorimi i aplikacioneve si PayPal apo Skrill në vend të futjes së drejtpërdrejtë të të dhënave nga kartela japin siguri se informatat e Juaja nuk do të jenë të vjedhura dhe të keqpërdoruar në vend të futjes së drejtpërdrejtë të të dhënave nga kartela japin siguri se informatat e Juaja nuk do të jenë të vjedhura dhe të keqpërdorura.

Duhet të blihet në faqet e njohura, siç janë botërisht të njohura e Bay, Amazon, AliExpress, të cilat janë treguar si internet shitore të mira të cilat bëjnë dërgesë të sigurtë deri në Republikën e Maqedonisë dhe ku nuk do të keni problem me sigurinë e të dhënave nga kartelat tuaja.

- Duhet të merret parasysh se blerja e prodhimeve nga interneti mund të sjellë shpenzime të paparashikueshme siç është për shembull shpenzimet për porositë si dhe doganimit i prodhimit (nëse e kalon shumën e caktuar me ligj)
- Prodhimi të cilat blihen prej së largu shpesh herë nuk kanë garantë, madje nëse prodhimi i njëjtë prishet nuk ka mundësi të servisohet pa pagesë. Prodhimet e caktuara, si është psh. Marka të njohura të telefonave celularë dhe aparatet tjera teknike të cilat tani më i ka në shitoret tona nuk mund të blihen përmes internetit dhe të sjellin në Republikën e Maqedonisë.

● AKTIVITET – PRINDËRIT E MI MË BLENË PRODHIM PËRMES TV SHOPIT I CILI NUK MË PËLQEU DHE NUK I PLOTËSOI ARRITJET E MIA

Qëllimi – nxënësi/nxënësja të pasurohen me njohuri praktike për atë se çka është marrëveshja së largu në çka të kenë kujdes dhe cilët janë të drejtat e tyre.

Mjetet mësimore: fllomasterë, tabelë, shkumës, disa shembuj nga marrëveshjet, prodhimet e porositura etj.

Vendi i realizimit: klasa

Kohëzgjatja e aktivitetit: dy orë mësimore dhe hulumtim në kohën e lirë.



Shembuj:

Përmes teleshopit me prindërit e mi porosita atlete për vrapim, që supozova duke e shikuar reklamën, dhe se janë shumë të rehatshme dhe i japin mbështetje trupit. Pas porosisë së prodhimit konstatova se në fakt nuk ishin të nejtja ashtu si në reklamë, cilësia dhe efektiviteti nuk i plotësuan arritjet e mia. Reaguam te shitësi, tentuam t'i tregojmë për mangësitë dhe kërkuam të na i kthejnë të hollat por ai nuk u pajtua.

Mësimdhënësi e ka broshurën „Të drejtat e konsumatorit që dalin nga marrëveshja specifike” me kthesë kah vepra bën marrëveshje nga larg dhe ka përgatitur Kuiz – pyetje.

Ai aktivitet fillon me parashtrimin e këtyre pyetjeve:

Nëse blini ndonjë prodhim përmes telefonit, letrës, faksit, postës elektronike në bazë të shitjes me katalog vallë e dini se çfarë kontrate keni bërë? Arsimtari ju sqaron nxënësve se Arsimtari ju sqaron nxënësve se ato janë kontrata prej së largu dhe shpjegon se çka është karakteristikë për këto marrëveshje.

Nxënësit ndahen në dy grupe dhe marrin pjesë në kuiz.

KUIZ PYETJE TË OFRUARA:

1. Në cilin lloj të kontratave bien kontratat për shitblerje të prodhimeve përmes top-shop? Во кој вид договори спаѓаат договорите

A) Kontrata shitblerjeje.

B) Kontrata mes personave jo prezent ose kontrata prej largësie.

C) Tip i veçantë i kontratave.

2. Për çka duhet të jetë i informuar harxhuesi?

A) Për identitetin e shitësit dhe adresën e tij, karakteristikat themelore të prodhimit, çmimin e prodhimit, harxhimet për dërgesën, mënyrën e kthimit restitucion dhe harxhimet eventuale, kohëzgjatja e ofertës dhe çmimit të ofertës, harxhimet e komunikimit.

B) Vetëm për çmimin e prodhimit.

C) Vetëm për kohëzgjatjen e ofertës.

3. Nëse konsumatori merr prodhim i cili nuk u përgjigjet pritjeve ka të drejtë të kërkon kthimin e parave në afat prej:

A) 15 ditë.

B) 22 ditë.

B) 7 ditë.

4. Në çfarë afati konsumatori duhet t'i merr mjetet e paguara?

A) Në afat jo më shumë se 30 ditë.

B) Në afat jo më shumë se 45 ditë.

C) Në afat jo më shumë se 7 ditë.

5. A ka obligim konsumatori të marr tjetër prodhim në zëvendësim të prodhimit të kthyer edhe pse nuk i përgjigjet dhe nuk i plotëson pritjet e tij?

A) Po.

B) Jo.

C) Vetëm në rast se shitësi nuk do të i kthej paratë.

6. Në çfarë gjendje konsumatori mund të ia kthej prodhimin shitësit?

A) Prodhimin duhet të jetë i pa dëmtuar, në paketim origjinal, me llogari fiskale dhe me të gjitha dokumentet plotësuese.

B) Prodhimi mund të jetë i përdorur.

B) Prodhimi mund të kthehet pa llogari fiskale.

7. Si duhet të jetë i shprehur çmimi i prodhimit?

A) Në denarë.

B) Në deviza.

C) Në denarë me TVSH të kalkuluar.

B) Deri te Inspektorati shtetëror i tregut dhe/ose deri te Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë.

8. Deri ku mund të drejtohet konsumatori?

A) Deri te Ministria e ekonomisë.

C) Deri te Agjenca për ushqim dhe veterinarë.

Fitues është grupi me më shumë përgjigje të sakta.

Detyra për hulumtime të mëtutjeshme/plotësuese

Për shkak të aktualitetit të problematikës, nxënësit mund të vazhdojnë me hulumtimet duke e hulumtuar tregun përmes internetit dhe si të bëjnë preventivë. Çdoherë udhëzoni, mbliidhni dhe filtroni informatat dhe keni kujdes formën e detyrës projektuese.

Disa nga strategjitë të cilat e mbajnë vëmendjen e nxënësve dhe e përmirësojnë mësimin aktiv:

- *Tërhiqeni vëmendjen e tyre.* Përdorni aktivitete të ndryshme hyrëse ose “ pushtuesit e vëmendjes”, me qëllim që ti animoni nxënësit për temën. Theksoni pse ajo është shumë me rëndësi dhe se si ajo do t’ju ndihmojë në jetë.
- *Planifikoni përmbajtje të pranishme dhe interesante.* Qartë sqaroni rëndësinë dhe qëllimin e çdo përmbajtjeje. Tregoni nxënësve çka pritni nga ata, pka duhet të arrijnë dhe ndihmoni ata të jenë krenar në përparimin e tyre.
- *Punoni së bashku.* Potencioni pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mësim. Nxitini që vet ti përmirësojnë gabimet e veta, të mësojnë nga ata dhe të sjellin vendime të drejta si konsumator. Nxitni bashkëpunimin, në vend të garave, që të mund të mësojnë njëri prej tjetrit.
- *Zhvilloni pesë karakteristikat më kryesore të nxënësit:* kreativitetin, produktivitetin, kureshtjen, bashkëpunimin dhe empatinë.
- *Krijoni ekipe për hulumtim dhe për punë në projekte të përbashkëta-* ashtu do ti përmirësojnë shkathtësitë e tyre ndërnjerzore.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

366:371.14.048.4(497.7)(035)

DORACAK për të drejtat e konsumatorëve në lëndën shkathtësitë e jetesës / [autorë Marijana Lonçar-Velkova ... и др.] - Shkup : Organizata e konsumatorëve në Maqedoni, 2014. - 66 стр. : илустр. ; 28 см

ISBN 978-9989-9592-5-7

1. Lonçar-Velkova, Marijana [автор]

а) Потрошувачки права - Наставници - Едукација - Македонија - Прирачници

COBISS.MK-ID 97516554